Pikërisht për këtë, në këtë takim vjetor të Rrjetit u përcaktuam për temën e cila është ngushtë e lidhur me metodologjinë e punës së Mekanizmave parandalues nacional, përkatësisht me strategjitë për parandalimin dhe mbrojtjen nga represaliet. Gjithashtu, e kishim parasysh se Protokolli Fakultativ në mënyrë eksplicite ndalon që organet dhe funksionarët e pushtetit të urdhërojnë, të zbatojnë, lejojnë ose tolerojnë çfarëdo qoftë sanksioni kundër cilitdo qoftë person ose organizatë për shkak të informatave të cilat i kanë dërguar deri te Mekanizmi Parandalues Nacional, pavarësisht se a janë ato të vërteta ose jo.

Po ashtu, obligim i ynë është ta ndjekim respektimin e këtij ndalimi, njësoj si edhe përgjegjësinë për marrjen e masave përkatëse për zvogëlimin e rrezikut nga represaliet e mundshme kundër personave ose organizatave për shkak të informatave që na i dërgojnë.

Dua t'ju përkujtoj se, duke e ditur seriozitetin e kësaj problematike, trupat kontraktues të Kombeve të Bashkuara i kanë miratuar "Udhëzimet kundër frikësimit dhe represalieve", ndërsa Komiteti kundër Torturës në mënyrë plotësuese i ka miratuar edhe "Udhëzimet për pranim dhe veprim sipas të dhënave të pranuar për represalie kundër personave dhe organizatave me të cilat bashkëpunojnë".

Po ashtu, edhe Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës ka miratuar "Politikën e vet të veçantë kundër represalieve", për implementimin praktikë të të cilit do të kemi mundësi të dëgjojmë nga përfaqësuesit e pranishëm.

Ndërsa ne, Mekanizmat parandalues nacional, duke e ndjekur shembullin e këtyre trupave dhe seriozitetin e kësaj dukurie duhet të synojmë drejt përmirësimit të politikave dhe strategjive, me qëllim të zvogëlimit të rrezikut nga frikësimi dhe represaliet, si dhe sigurimit të mbrojtjes adekuate të viktimave.

Duke e pasur parasysh këtë, pres që në këtë takim, përmes shkëmbimit të përvojave, si dhe përmes shkëmbimit të mendimeve, do të kontribuojmë në përmirësimin dhe harmonizimin e strategjive për parandalimin dhe mbrojtjen nga frikësimi dhe represaliet.

Njëkohësisht, pres të miratojmë qëndrime dhe konkluzione të përbashkëta se si ta përmirësojmë punën tonë në luftën kundër torturës në vendet e ndalimit dhe privimit nga liria, veçanërisht si ta përforcojmë veprimin tonë që ka të bëjë me parandalimin dhe mbrojtjen nga represaliet, e që gjithsesi do të na forcoj edhe si mekanizëm për parandalimin e torturës edhe si institucione të Ombudsmanit në angazhimin për zero tolerancë të torturës dhe veprimeve të tjera jonjerëzore ose ndëshkuese.

Ju faleminderit dhe Ju dëshiroj punë të suksesshme.



Ambasador Klemens Koja


Shef i Misionit të OSBE-së në Shkup

Avokat i Popullit, Ixhet Memeti,
Zonja dhe zotërinj,

OSBE konsideron se institucionet e fuqishme dhe të pavarura nacionale për të drejtat e njeriut janë të domosdoshme për zbatimin efikas të obligimeve për të drejtat e njeriut. Në Dokumentin e Kopenhagës të vitit 1990, shtetet pjesëmarrëse në OSBE u angazhuan në drejtim që të "lehtësojnë dhe fuqizojnë krijimin e institucioneve të pavarura nacionale në fushën e të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës".

Viteve të kaluara, Avokati i Popullit i Maqedonisë së Veriut i zgjeroi kompetencat e tij. Institucionit i janë dhënë detyra plotësuese – përfshirë edhe veprimin si trup mbikëqyrës të policisë, si kornizë e pavarur për monitorimin e zbatimit të Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe si amicus curiae në rastet gjyqësore. Krahas kësaj, u rrit edhe buxheti i institucionit, si dhe personelit të rekrutuar, i cili duhet t'i ndihmojë institucionit t'i shfrytëzoj të drejtat e tij. Sidoqoftë, institucioni Avokat i Popullit ende ka nevojë për përforsim plotësues në mënyrë që t'i përmbush obligimet e reja të tij, për shembull, në Mekanizmin e tij Parandalues Nacional. Mekanizmat parandalues nacional nuk mund të jenë efektivë, nëse nuk janë të aftë që në mënyrë të drejtë t'i kryejnë funksionet e tyre. Hartuesit e "Protokollit Fakultativ të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës" në mënyrë eksplicite parashikojnë obligime ligjore për shtetet nënshkruese në lidhje me pavarësinë, mandatin dhe resurset buxhetore të mekanizmeve të këtillë. Megjithatë, edhe krahas përforsimit të kohë më parshëm sa i përket personelit, Mekanizmi Nacional Kundër Torturës ende ka nevojë për resurse plotësuese njerëzore por edhe resurse financiare në mënyrë që të mund ta kryej drejt punën e vet.

Ne, jemi mbledhur sot për të diskutuar për "Politikën Nacionale për Mekanizmin Parandalues për Represaliet". Kjo temë është tejet e rëndësishme për funksionimin e drejtë të Mekanizmit Parandalues Nacional. Anëtarët e tij duhet të mund të punojnë pa kërcënime ose sanksione kundër tyre. Gjithashtu, duhet t'i kushtohet vëmendje edhe një çështjeje tjetër -



sigurimit të mbrojtjes nga hakmarrja kundër personave të privuar nga liria dhe kontaktet e tyre të cilët komunikojnë me trupat e monitorimit. Frika nga hakmarrja është pengesë serioze për monitorimit efikas. Me padurim e presim diskutimin Tuaj për strategjitë për zgjidhjen e kësaj sfide.

Në fund, dua ta lavdëroj institucionin Avokat i Popullit për gjithë punën e tij dhe veçanërisht për Mekanizmit Parandalues Nacional. Megjithatë, duhet të kalojmë edhe shumë beteja derisa të zhvillohet një shoqëri e çliruar nga tortura dhe nga llojet e tjera të veprimit brutal, jonjerëzor, përçmues ose ndëshkues. Ne jemi të gatshëm të vazhdojmë të krijojmë relacione për fuqizimin e institucioneve të Avokatit të Popullit.

Ju dëshiroj diskutim të suksesshëm.

Ju faleminderit



Ermonela Khafa

Komisionere e MPN Shqipëri

Çka nënkuptohet nga “sanksionet për hakmarje”?

Nocioni “hakmarje” shpesh përdoret për t’i përshkruar praktikat ndëshkuese të imponuara nga rojtarët ose organet kompetente për arrestimin e të paraburgosurve të cilët kanë paraqitur ndonjë rast të mbikëqyerësit e pavarur. Megjithatë, “hakmarja” definohet si akt i shpagimit, i cili nuk është preciz dhe konkret, duke marrë parasysh se pasojat e shkaktuara mbi personat e nënshtruar ndaj torturës dhe llojit tjetër të keqtrajtimit nuk rezultojnë nga “kundërvajtja” e kryer që gjoja justifikon hakmarjen ose dënimin¹.


Në realitet, hakmarja duhet të konsiderohet si kërcënim për misionin e MPN-së për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit. Edhe pse aksionet hakmarëse nuk janë fenomen i ri, vetëdija për këtë është në rritje viteve të fundit, sidomos me hyrjen në fuqi të Protokolit Fakultativ nga Konventa e OKB-së kundër torturës (OPKAT) dhe zgjerimit të numrit të mekanizmeve parandalues nacional.

Roli i Mekanizmit Parandalues Nacional (MPN)

Ne si ekspertë të MPN-së në përgjithësi konsiderojmë se masat disiplinore ndikojnë negativisht ndaj gjendjes psikike të personit dhe raporteve me të burgosurit e tjerë. Organeve për mbikëqyrje të themeluara me OPKAT-in u janë dhënë autorizimet në vijim të cilat zakonisht duhet të parandalojnë sanksionet eventuale kundër tyre: qasje pranë të gjitha informatave që kanë të bëjnë me trajtimin e personave të paraburgosur, qasje pranë të gjitha vendeve të paraburgimit, mundësi të kenë intervista private me personat e privuar nga liria, liri për t’i zgjedhur vendet që duan t’i vizitojnë dhe personat që duan t’i intervistojnë². Asociacioni për parandalimin e torturës ashpër i dënon të gjitha format e hakmarjes lidhur me vizitat e vendeve të privimit nga liria. Ato jo vetëm që janë shkelje e të drejtave të njeriut, por janë edhe kërcënim për misionin e organeve për mbikëqyrje.

¹ Nenet 15 dhe 21 të OPKAT-it

² Shiko OPKAT-in nenin 20



Gjatë kohës së vizitave, ne si organ për mbikëqyrje shfrytëzojmë metodat të cilat janë të dobishme për zvogëlimin e rrezikut nga hakmarja, të cilat përfshijnë:

- Garantimin e kohës së duhur të kaluar në çdo vend të vizituar.
- Të mundësohet privatësi gjatë kryerjes së intervistave.
- Mbajtje e intervistave me sa më shumë persona që të mund të njihen më lehtë.

Rregullat për konfidencialitet, të cilat i kufizojnë disa organe të cilat i vizitojnë institucionet, çdo herë duhet të jenë të harmonizuara me parimet humanitare dhe nevojën për mbrojtje.

Veprime për mbrojtjen e personave të privuar nga liria

Realizoni intervistat në privatësi absolute: pa përgjime dhe sipas mundësisë sa më shumë, të sigurohet kontrolli vizual (edhe i personelit edhe i të paraburgosurve).

Shmangni formulimi e rekomandimeve, propozimeve ose peticioneve të personave të paraburgosur menjëherë pas intervistave.

Kur e vizitoni vendin e privimit nga liria, shmangni kërkesat kolektive të hapura nga ana e personave të paraburgosur, sepse në këtë mënyrë, të njëjtat mund të zbulohen.

Jepni ndihmë dhe këshilla personave të burgosur ose familjarëve të tyre edhe në fushën e gjyqësorit, por edhe lidhur me çështjet administrative.

Ngritje e vetëdijes së opinionit publik për të drejtat e personave të privuar nga liria.

Ngritje e vetëdijes për mandatin e organit për mbikëqyrje: Shumica e mekanizmave për vizitë punojnë pas skenës, që gjithashtu është pjesë e (të paktën në rastin e MPN-së) dialogut konstruktiv që e kanë me organet kompetente.

Mbikëqyrja çdo herë duhet të udhëhiqet nga parimi “të mos bëhet dëm” dhe duhet të ndërmerren të gjitha aktivitetet e mundshme për të zvogëluar rrezikun nga sanksionet e shkaktuara ndaj atyre të cilët pajtohen të bashkëpunojnë me ta gjatë kohës së vizitave të tyre.

Shembuj konkret nga mbikëqyrjet, si dhe referenca juridike

A.S. 38 vjet, i dënua me 9 vjet burg për tentim për vrasje në rrethana të kualifikuara, ishte shpërblyer duke i lejuar vizitë nga anëtarët e familjes së tij në periudhë prej katër ditëve në muajin qershor. Për shkak të konfliktit me bashkëqytetarët e tjerë, mungesa e dhuruar për A.S ishte anuluar dhe për një javë ishte përjashtuar nga të gjitha aktivitetet grupore. Kuptohet, reaksioni ndaj kësaj mase ishte kontravers dhe nuk ishte e mirëpritur.

Në bazë të shembullit të lartpërmendur, pyetja e cila duhet parashtruar është përse dhe a duhet të ketë masa disiplinore në institucionet ndëshkuese-korrektuese. A ndikon ky lloj i komunikimit ndaj të drejtave të personave me liri të kufizuar? Sanksionet duhet të jenë të logjishme lidhur me veprën penale dhe rrethanat e të burgosurit, duke përfshirë edhe historiatin disiplinor dhe çfarëdo sëmundje mendore ose çrregullime të tjera kognitive.

Burgjet në Shqipëri gjatë kohës së regjimit komunist shikoheshin vetëm si vende për ndëshkime dhe marrëdhënie të kufizuara në komunikim me botën e jashtme dhe në burg, ndërsa ekzistimi i masave disiplinore për persona me liri të kufizuar në kohën e sotshme, ju çon të përkujtoni dhe mendoni për këtë lloj komunikimi dhe për efektet pasuese dhe interaktive. Masat disiplinore mund të konsiderohen si masa kufizuese për personat me liri të kufizuar. Në realitet, dispozitat ligjore definojnë si një proces i komunikimit me qëllim që të përmirësohet sjellja e papranueshme në rrethin në të cilin ruhen.

Hakmarja fillimisht krijohet nga ana e rrethinës e cila i mundëson të njëjtës të ndodhë. Mund të cekim tre arsye kryesore për zbatimin e masave në këto institucione:



1. Mbipopullimin;
2. Përpjekje për të hyrë në regjimin e sendeve të ndaluara
3. Konfliktet ndërmjet të burgosurve

Në nenin 51 nga Rregullorja e përgjithshme e burgjeve definohen masat e dhëna në raste të dëshmive për shkelje të disiplinës në bazë të klasifikimit të cenimit të kryer. Për kundërvajtje disiplinore shumë të rënda, shqiptohen masa me përjashtim nga të gjitha aktivitetet e përbashkëta deri më 20 ditë, vendosje në ambiente specifike dhe ndërprerje të lejeve për një periudhë prej 6 muajve. Për kundërvajtje serioze disiplinore, shqiptohen masa me përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta deri më 10 ditë në ambiente specifike, përjashtime nga daljet jashtë në grupe, por jo më shumë se 20 ditë. Paralajmërimet, si dhe vërejtjet në prani të të burgosurve, shqiptohen për kundërvajtje që konsiderohen të lehta. Ligji 8328 "Për të drejtat dhe veprimet me të burgosurit dhe të paraburgosurit" prashikon masa më të lehta për gra dhe persona të mitur, me çka e përgjysmon kohën për masat e lartpërmendura.

Si do që të jet, personat e mitur duhet të trajtohen si viktimat, dhe jo si kriminel, edhe pse sjellja e tyre është e rrezikshme, por kjo nuk don të thotë se do t'ju falen gabimet, por se duhet të trajtohen më mirë gjatë rrjedhës së procedurës dhe të përcaktohen masat më përkatëse për ato.

Për të përcaktuar se a është vepra cenim, neni 52 i Rregullores së përgjithshme për burgjet parashikon formimin e Këshillit disiplinor dhe mënyrën e veprimit. Në raste të cenimeve më të lehta, masën e vendos drejtori i institucionit, pasi që t'i sqarojë rrethanat dhe të komunikojë me të burgosurit, për arsye se garantohet e drejta e mbrojtjes. Masën disiplinore e përcakton Këshilli disiplinor, të cilin e përbëjnë drejtori i Institucionit në cilësi të kryetarit, si dhe të punësuarit në Sektorin për Mbrojtje Sociale, shëndetësi, shërbimet juridike dhe policore, kur konstatohen shkelje serioze në Nenin 51 nga rregullorja për burgjet³. "Kundër aktvendimit të Këshillit disiplinor, i burgosuri ka të drejtë të paraqet ankesë me shkrim në afat prej 15 ditëve pranë Komisionit për ankesa të Drejtorisë së përgjithshme për burgje, përbërja e të cilës është caktuar sipas urdhërit të drejtorit të përgjithshëm të burgjeve".


Nga inspektimet e bëra si MPN, vërejtëm se respektimi i të drejtës për ankesë të personave me liri të kufizuar ndaj masave të shqiptuara disiplinore, rreptësisht vëzhgohet nga strukturat përkatëse në BDP. Të gjitha parashtresat e parashtruara janë shqyrtuar me seriozitet dhe shumica prej tyre u bënë pjesë e detyrave inspektuese të institucioneve të cilat u kundërshtuan për shqiptimin e masave të tilla. Nga kontrolli i regjistrave për masa disiplinore, është zbuluar se pothuajse ndaj çdo institucioni të vëzhguar, për shkak të përgjimeve dhe përdorimit të sendeve të ndaluara nga ana e të burgosurve, u janë shqiptuar masa disiplinore. Këto të dhëna janë në lidhje të ngushtë me sigurinë e këtyre institucioneve. Nga monitorimi u tregua se sendet e ndaluara shpesh janë: celularët, drogat narkotike, mjetet për prerje. Mungesa e pajisjes për skenim, në disa burgje mungesa e masave kontrolluese për kontroll të ushqimit, mundësojnë transferimin e mjeteve të ndaluara në këto institucione. Në disa raste, të burgosurit pohojnë se këtë "shërbim" e kryejnë persona të korrumpuar me "pagesë". Për shembull, në një rast në burgun në Korçë, që ishte publikuar nga ana e mediave. Gjatë muajit dhjetor të vitit 2015, Kodi penal i Republikës së Shqipërisë ishte ndryshuar, duke ashpërsuar sanksionet, lidhur me ndëshkimin e personave që tentojnë të fusin ose përdorin sende të ndaluara në burgje.

STATISTIKA

Për vitin 2018, janë zbatuar 1075 masa disiplinore për të gjitha burgjet

Për vitin 2019 deri më tani janë zbatuar 461 masa disiplinore për të burgosurit në të gjitha burgjet

³ Njëlloj, neni 52,2,-3 12, neni 52/1.1-2



Për persona të mitur:

- Për vitin **2018**, nuk është shqiptuar masa disiplinore.
- Për vitin **2019**, deri më tani janë shqiptuar 3 masa **"Paralajmërimë"**

Siç mund të shohim nga tabela më poshtë, masa disiplinore sa më shpesh që shqiptoheshte në institucionet e mbikëqyrura rezultonte **me përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta deri më 20 ditë**. Pas kësaj mase vijon masa disiplinore për lirim nga daljet jashtë në grupe. Në lidhje me procedurën që realizohet për shqiptimin e masës, ka pasur raste të kohëpaskohëshme, sporadike të mosrespektimit të normave procedurale të parashikuara me ligj dhe rregullore.

MASA DISIPLINORE PËR TË BURGOSURIT DHE TË PARABURGOSURIT NË BURGJET					
Viti	Këshillim individual	Hakmarje në prani të të burgosurve	Përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta deri më 10 ditë	Përjashtim nga dalja në grupe, jo më shumë se 20 ditë	Përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta deri më 10 ditë
2018	119	3	200	185	513
Janar – Maj 2019	66	4	111	59	190

Në lidhje me respektimin e të drejtës në favor të shqiptimit të shpërblimit – lejes, të marrim një shembull, në INK "Ali Demi" është evidentuar rasti kur drejtori e ka miratuar daljen e shpërblimit – lejes por GDP ka hedhur poshtë lejen përmes telefonit por jo me letër zyrtare.

Organi kompetent për dhënien e shpërblimit – lejes është udhëheqësi i institucionit, ndërsa GPB ka për detyrë t'i planifikojë lejet⁴.

Problemi egzistues është mosdhënia e shpërblimeve – lejeve personave me shtetësi të huaj. Ky është një problem që duhet të rregullohet, ndërkaj jo të shkelet e drejta.

Personat të cilët e kryejnë mbikqyrjen çdo herë duhet të udhëhiqen nga parimi "të mos bëhet dëm" dhe ti ndërrmarin të gjitha aktivitetet e mundëshme për të zvogëluar rreziqet nga sanksionet e imponuara ndaj personave të cilët janë të pëlqimit të bashkëpunojnë gjatë kohës së vizitave të tyre.

Si konkluzion, mund të themi se është i njohur mirë fakti që burgjet dhe vendet e paraburgimit janë vende ku personi është i privuar nga liria dhe është i kufizuar nga komuniteti me botën e jashtme. Ky komunikim është i kufizuar për arsye se i burgosuri duhet t'i përshatet rregullave të burgut, me të cilat përcaktohen kufinj të sjelljes së një personi në burg. Kuptohet se, vendosja në burg e personit është në lidhje me gjendje të rëndë psikike të personit, por jo vetëm kjo, mund të themi se kjo mund të shkaktojë gjendje të rëndë madje edhe te anëtarët e familjes së tij. Shpeshherë, ata nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe

⁴ Duke u përqëndruar në urdhërin e ministrit për drejtësi nr 103, të datës 14.02.2014 "për zgjidhjen e çështjeve të caktuara lidhur me shpërblimin ose ndarjen në mënyrë të veçantë të lejeve të personave zyrtarë" konkludohet se drejtori i institucionit për ekzekutimin e aktvendimeve kriminalistike, është organ kompetent për shqyrtimin e kërkesave dhe aktvendimeve të shpërblimeve të burgjeve të rëndomtë dhe burgjeve me sistem të dobët të sigurisë. Pasiqë të përfundon procedura juridike për shqyrtimin e kërkesave, drejtori i burgut me letër të veçantë, e njofton drejtorin e përgjithshëm i cili vendos për planifikimin e lejes.




rregullat të cilat medoemos duhet ti zbatojnë, gjë që e vështirëson procesin e adaptimit dhe mënyrën e sjelljes së tyre. Masat disiplinore nuk duhet të konsiderohen si formë e ndëshkimit por si proces i komunikimit për ngritjen e vetëdijes së personit me liri të kufizuar, të analizojë sjelljen e tij dhe performansat në institucion. Forma, përmbajtja, mënyra dhe zbatimi i këtij procesi janë elemente të definuara në dispozita të ndryshme ligjore vendore dhe ndërkombëtare. Të shqiptohet masa disiplinore nuk është e lehtë siç shikohet çdo herë në dy mënyra: fleksibilitet gjatë trajtimit dhe komunikimit me të burgosurit që i mundëson çdo personit hapësirë dhe dinjitet personal dhe krijim i sistemit të sigurisë.

Në procesin e këtij mekanizmi komunikativ, duhet të merren parasyshë disa faktorë që mund të kenë ndikim pozitiv mbi përmirësimin e masave disiplinore:

- Përmirësimi i procedurave për ankesa të personave me liri të kufizuar ta tërheqin masën e shqiptuar;
- Asnjë organ mos të tolerojë dënimin kundër cilit do person për kontaktet me organin për mbikqyrje, kjo konsiderohet për element kyç në luftën kundër torturës dhe parandalimit të torturës. Derisa personat e privuar nga liria janë të nënshtruar ndaj sanksioneve të shqiptuara nga organet për paraburgim, nuk duhet të harohet se familjarët e tyre, të punësuarit në vendet e paraburgimit madje edhe anëtarët e organeve për mbikqyrje, gjithashtu, mund t'i nënshtrohen masave të tilla të ndëshkimit.
- Përveç këshillimit medicinal është e nevojshme të shqyrtohet qëndrimi i psikologut për opsionet dhe efektet mbi shëndetin mendorë të personit; dhe
- Të krijohet "mini-bibliotekë", në hapësirat për separim/ndarje.

Shfrytëzimi i të drejtave dhe respektimi i obligimeve kontribuon për shmangien e paligjshmërisë. Kuptohet, synimi i fundit i zbatimit të rregullave është respektimi i dinjitetit të njeriut dhe mbrojtja e jetës. Por, në çdo rast, e drejta nuk ndalet para burgut.



Peter Kastner

President i grupit juridik dhe Bordit të Avokatit të popullit Austriak

Vërejtje të përgjithshme

Avokati i popullit i Austrisë (AOB) dhe gjashtë komisionet e tij multi – disiplinore, me rregull i përcjellin institucionet publike dhe private të cilat janë të klasifikuara si “vende për privim nga liria në kuptim të nenit 4 të OPCAT” në nivel kombëtarë. Objektivi kryesorë i MNP është zbulimi i deficiteve strukturore të cilët mund të rezultojnë me raste të administrimit jo përkatës.

Si kompetenca plotësuese të parandalimit nga ana e MNP janë inspektimet e institucioneve dhe programeve të përcaktuara për personat me nevoja të posaçme, për shkak të nenit 16, paragrafi 3 të OKB – CRPD, si dhe monitorimi dhe kontrollimi i njëkohshëm i organeve kompetente të autorizuara që të ushtrojnë forcë të drejtpërdrejtë administrative dhe masa të detyrimit. Këto kompetenca parandaluese mund të përputhen me mandatin e OPCAT dhe të njëjtit mund ta plotësojnë të njëjtin.

Komisionet e lartpërmendura kanë realizuar më shumë se 500 vizita gjatë vitit 2018. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë vizita të para dhe janë realizuar në institucionet psikiatrike, institucionet shëndetësore, shtëpitë e pleqve dhe të pensionistëve, institucionet e përcaktuara për mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve. Disa herë me radhë janë vizituar një numër i madh i vendeve klasike të përcaktuara për paraburgim, siç janë institucionet përmirësuese, stacionet e policisë dhe qendrat policore të përcaktuara për paraburgime. Të gjitha vizitat realizohen në pajtim me metodologjinë për monitorim, të zhvilluar nga ana e MNP dhe sipas standardeve tjera të unifikuara.

Informacionet dhe vërejtjet e regjistruara nga ana e komisioneve janë të dokumentuar në suaza të raporteve gjithëpërfshirëse nga vizitat e realizuara: gjithsej 3.134 raporte janë të përpiluara gjatë vitit 2012.

Nga vetë fillimi AOB i tuboi rekomandimet të cilat i përmbledhin rezultatet nga raportet e komisioneve. Vitin e kaluar u formuluan 179 rekomandime të reja. Këto rekomandime janë të dizajnuara që institucioneve dhe personelit të angazhuar atje tu sigurojë orientimin përkatës.



sipas të cilit duhet të garantohen standardet për të drejtat e njeriut. Për këtë qëllim, është e domosdoshme që të zmadhohet vetëdija për të gjithë faktorët e involvuar për atë që nënkupton trajtimin e personave me dinjitet njerëzorë.


Për përmbushjen e detyrave të veta, MNP duhet të garantojë qasjen përkatëse për realizimin e intervistave private me personat e privuar nga liria, në mënyrë të besueshme pa dëshmitarë. Komisionit gjithashtu duhet ti ofrohet mundësia që të mund të realizojë intervistime diskrete me cilindo person tjetër i cili gjendet në objektin, i cili mund të ofrojë informacione relevante, duke e përfshirë këtu edhe personelin, nëpunësit zyrtarë, mjekët, psikiatri dhe punonjësit social, etj. Të gjithë personat që ofrojnë informacione për MNP nuk mund të jenë lëndë e sanksioneve ose hakmarrjes për shkak të ofrimit të informacioneve për MNP. Për këtë qëllim, ne i përcjellim Udhëzimet kundër frikësimit ose hakmarrjes (të a.q. "Udhëzimet San Hoze"). Prapëseprapë, ne do të fokusohemi drejtë disa situatave specifike të cilat duam që ti theksojmë në veçanti.

Masat specifike

Si orvatem që të pengojmë frikësimin ose hakmarrjen? Çdo herë kur i pyesim njerëzit se vallë pajtohen që të intervistohen, ne sigurohemi se mund të realizojmë bisedime private me të njëjtit. Nëse këta persona intervistohen në hapësirë të veçantë, ne sigurohemi që personeli të jetë i pozicionuar jashtë, të qëndrojë jashtë perimetrit të dëgjimit dhe pamjes. Kuptohet se do të jetë shumë më lehtë që të realizoni kontakte me të burgosurit, dhe kur do ti intervistoni të njëjtit në suaza të mjedisit ku jetojnë të njëjtit. Nëse ata e ndajnë hapësirën me të burgosurit tjerë, duhet të sigurohemi se partnerët tanë të intervistimit pajtohen me një gjë të tillë. Në këtë mënyrë ne sigurojmë më tepër informacione për kushtet e jetës në këto objekte, meqenëse të tjerët mund të ndërhyjnë dhe ofrojnë informacione plotësuese. Do të thotë, ajo që fillon si një lloj dialogu mund të përfundojë si diskutim në grup. Sido që të jetë, duhet të jemi të vetëdijshëm për faktin se pas braktisjes së objektit mund të jemi shkaktarë të konfliktit subtil në mes shokëve të dhomës, gjë që mund të shndërrohet në hakmarrje të partneri ynë i intervistimit. Edhe pse kemi garantuar besueshmëri të bisedimeve ndaj të punësuarve, përkundrazi kemi shkaktuar gjendje të tensionuara dhe konfliktuoze në mes shokëve të dhomës.

Në rastet kur bisedojmë me grupet e cenuara, të cilët çdoherë janë minoritete, duhet të marrim parasysh faktin se është e lehtë që të zbulohet se kujt i jemi drejtuar, pa dallim se vallë i kemi përmendur ose jo emrat e partnerëve tanë të intervistës. Do të thotë, në këtë rast fitohet përshtypja se është më mirë që të mos theksohet gjendja specifike e bisedës së fundit, por të pyetet udhëheqësia se si ata ballafaqohen me situatat e përgjithshme, duke ngushtuar në këtë mënyrë temën e bisedimit hapë pas hapi, pasi të kenë fituar informacione nga vetë udhëheqësia. Me fjalë të tjera, çdo herë duhet të mbahet llogari që pas vetes të lëmë sa më pak indikacione të jetë e mundur.

Të gjithë personat të cilët komunikojnë me MNP, pa marrë parasysh faktin se vallë janë persona të arrestuar, pacientë, të punësuar në qendrat e paraburgimit, spitalet psikiatrike dhe në institucione të ngjashme, anëtarët e shoqërisë civile, përfaqësuesit shtetërorë dhe të tjerë, duhet të besojnë se çdo informacion i ofruar do të mbetet i besueshëm dhe se të njëjtit nuk do ti nënshtrohen asnjë lloji të hakmarrjes për shkakun se kanë ofruar informacionet e tilla. Ashtu siç u konstatua, personeli ndonjëherë është i paqartë, i turpshëm po në disa raste edhe i brengosur kur dëshiron që realizojë kontakte me anëtarët e MNP, gjatë realizimit të vizitave. Në veçanti infermieret e mjekësisë frikësohet se do të vrotohen nga ana e kolegëve ose nga ana e përgjegjës të tyre, në rastet kur ata ofrojnë informacione për MNP. Kështu që kemi pasur situata të çuditshme në një shtëpi të pleqve, kur infermierja insistonte që të bisedojë me komisionin në hapësirën e përcaktuar për pushim, hapësirë kjo e vetme në suaza të objektit ku mund të realizohej bisedimi në kushte të besueshme dhe diskrete. Që të evitohen këto situata ne e inkurajojmë personelin se informatat e tilla mund të plasohen në mënyrë anonime në zyrën tonë në çdo kohë. Secili mund të paraqitet në mënyrë anonime ose të shkruaj letër anonime. Nëse ne i fitojmë këto informacione pas vizitës së realizuar, një vizitë suksese mund



të organizohet menjëherë më pas. Personalisht nuk mbështes aktin e servimit të informacioneve. Por, duhet ta respektojmë situatën personale të të punësuarve.

Masat e mbrojtjes

Një shtet relevant nënshkrues duhet të miratoj masat e mbrojtjes, në raste të ekzistimit të rrezikut se ndonjë individ ose grup do të mund të jenë të ekspozuar ndaj frikësimit ose hakmarrjes për shkak të komunikimit me MNP. Masat e tilla në vete mund të përfshijnë përmbajtjen nga çfarëdo lloji i veprimit në drejtim të frikësimit ose hakmarrjes dhe të sillen të gjitha masat e domosdoshme për mbrojtjen e personave që janë në gjendje të rrezikut.

Për këtë arsye, MNP është i detyruar që ta njoftojë udhëheqësinë, personelin dhe personat e paraburgosur në të gjitha vendet e përcaktuara për paraburgime, se hakmarrja është rreptësisht e ndaluar me Protokollin fakultativ dhe në pajtim me këtë, organet kompetente do të sigurojnë ndalesë absolute për represione. Këto informacione shpërndahen në objekte të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe ndalesën absolute për hakmarrje si dhe informacionet për atë se si të barten informacionet në mënyrë të sigurt deri te MNP. Për këtë ne kemi botuar fashikuj, të cilët ua ndajmë gjatë vizitave të realizuara. Ne i inkurajojmë njerëzit që të parashtrojmë padi deri te këshilli i Avokatit të popullit, çdoherë kur do të hetojnë se ofrimi i informacioneve deri te MNP do të shkaktojë atyre çfarëdo lloji të kërcënimeve, kufizimeve ose hakmarrje. Gjithashtu, ne i informojmë palët e përfshira për kompetencat tona ë çdo kohë kur realizojmë kontaktet me të njëjtit dhe kur orvatemë që të themelojmë mirëkuptim për punën që ushtrojmë.

Kuptohet, është detyrë e jona që të ballafaqohemi në mënyrë të senzibilituar me të gjitha informacionet e natyrës diskrete të cilat i pranojmë. Të dhënat personale ose informacionet që mundësojnë identifikimin e ndonjë personaliteti, me përjashtim të rasteve kur nuk ekziston pajtimi i shqiptuar, klasifikohen si të dhëna të ndjeshme. Do të thotë, ne duhet të implementojmë monitorimin përkatës në një mënyrë që pamundëson zbulimin e të dhënave personale ose identifikimin e personalitetit. Për këtë arsye, kemi arritur pajtimin me anëtarët e komisioneve tona, që të japin udhëzime se si të fitojnë qasjen deri te të gjitha informacionet mjekësore, që janë të regjistruara për personat e burgosur në të gjitha institucionet përmirësuese. Kështu që, anëtari i komisionit që i kryen vizitat, mund të kërkojnë dosjet në mënyrë të pavarur, duke mos qenë të varur nga ndihma e personelit që i vrojton. Të njëjtit posedojnë fjalë kalime të cilat u mundësojnë që ti shqyrtojnë dhe kontrollojnë të gjitha dosjet relevante dhe ti filtrojnë informacionet e kërkuara.

Ngritja e vetëdijes


Parandalimi dhe reagimi ndaj hakmarrjes kundër personave që kanë ofruar informacionet deri te MNP është një segment i rëndësishëm i mandatit të MNP. MNP nuk posedon mandatin që të hulumtojë pohimet në lidhje me hakmarrjet. Për këtë arsye MNP në mënyrë sistematike duhet ti përkujtojnë shtetet në lidhje me obligimet e tyre që të sigurojnë ndalesën e represioneve në të gjitha vendet e përcaktuara për paraburgime, në mënyrë përkatëse të njoftojnë personelin për të gjitha vendet e përcaktuara për paraburgime dhe të implementojnë mekanizmat hetuese për zgjidhjen e pohimeve për ekzistimin e hakmarrjes; gjithashtu është e domosdoshme që të përcillet përmbushja e këtyre obligimeve.

Nëse MNP i Austrisë fiton përshtypjen se nuk përkrahjet në mënyrë efikase, menjëherë duhet të konsultohet me Organin këshillëdhënës për të drejtat e njeriut. Këshilli e përkrah Avokatin e popullit të Austrisë si organ këshillëdhënës. I njëjti përbëhet nga përfaqësuesit e Ministrive federale, krahina dhe nga shoqëria civile. Ky organ e përkrah Këshillin e Avokatit të popullit gjatë përcaktimit të pikave të fokusuara në lidhje me procedurat e vrojtimit, dhënies së deklaratave për menaxhim jo përkatës, zhvillimit të rekomandimeve dhe sigurimit të procedurave dhe standardeve permanente të inspektimit. Në këtë rast, ne kemi realizuar kontakte



edhe me shtypin dhe mediet, duke i informuar gazetarët për pengesat rrjedhëse, në këtë mënyrë të njëjtit na mundësojnë përmbushjen e mandatit tonë.

Legjislativi me relevancë (siç është akti legjislativ për themelimin e MNP) duhet të garantojë ndalesën e porosisë, zbatimit, lejimit ose të tolerimit të çfarëdo lloj të sanksioneve kundër çdo personi ose organizate në lidhje me ofrimin e çfarëdo lloj të informacioneve për MNP, pa dallim nga fakti se vallë kemi të bëjmë me informacione të sakta ose të rreme, dhe personat ose organizatat e tilla nuk lejohet që të bëhen viktimat të paragjykitimeve në çfarëdo lloj mënyre.



Silviya Slaveva, eksperte

Zyra e Avokatit të Popullit të Republikës së Bullgarisë

KORNIZA LIGJORE

- Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi Avokatin e Popullit, të shpallur në Gazetën zyrtare (GZ) nr.29, me datë 10 Prill, në vitin 2012, funksioni i MPN i është deleguar Avokatit të Popullit.
- Në ligj është përfshirë kapitull i ri, i cili i përkthen kërkesat e OPKAT-it.
- "a" Mekanizmi parandalues nacional (Gazeta zyrtare e re nr.29/2012 që ka hyrë në fuqi nga data 11.05.2012).

Neni 28 (a) (Gazeta zyrtare e re nr.29/2012 që ka hyrë në fuqi nga data 11.05.2012) (1) Kompetencat e Avokatit të Popullit si Mekanizëm parandalues nacional i referohen vendeve ku ka persona të privuar nga liria ose persona të paraburgosur ose të vendosur aty si rezultat i veprës ose konform organit shtetëror, vende nga të cilat nuk mund të largohen sipas dëshirës së tyre. Me qëllim të mbrojtjes së këtyre personave nga nënçmimi, ndëshkimi, tortura ose ndonjë veprimi tjetër mizor dhe johuman.

(2) Avokati i Popullit ka të drejtë:

1. të ketë qasje pa njoftim paraprak dhe në çdo kohë deri tek të gjitha vendet e paraburgimit dhe tek të gjitha objektet dhe instalimet e tyre;
2. të ketë qasje tek të gjitha informacionet në lidhje me numrin e personave të privuar nga liria në paraburgim, siç është definuar në nenin 1, si dhe numrin e vendeve dhe lokacionin e tyre;
3. nëse konsiderohet si e nevojshme të kryej intervista private personale ose me përkthyes dhe pa dëshmitarë me personat e privuar nga liria, si dhe me cilin do person tjetër për të cilin Avokati i Popullit si Mekanizëm parandalues nacional beson se mund të siguroj informacione relevante;
4. të ketë qasje tek të gjitha informacionet që i referohen sjelljes me personat nga neni



1, si dhe kushteve të tyre në paraburgim;

(3) sipas nenit 1 të punësuarit dhe personat zyrtar në objekte janë të obliguar që t'i ndihmojnë dhe t'i japin informacionet e nevojshme Avokatit të Popullit.

Neni 28 (b) (Gazeta e zyrtare e re nr.29/2012 e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.05.2012)

(1) Një person ose person zyrtarë nuk ka të drejtë që të porosisë, zbatojë ose lejojë çfardo qoftë sanksioni ndaj ndonjë personi apo organizate, nëse ata kanë paraqitur ndonjë informacion, pa dallim se a janë të vërteta apo jo, për Avokatin e Popullit si Mekanizëm parandalues nacional asnjë person ose organizatë e tillë nuk mund të pësoj asnjë dëm për shkak të asaj.

(2) Informacionet konfidenciale të mbledhura nga Avokati i Popullit si Mekanizëm parandalues nacional nuk mund të zbulohen. Të dhënat personale mund të publikohen vetëm pasi që personi të cilit i referohen pajtohet qartazi.

Neni (28) (g) (Gazeta e zyrtare e re nr.29/2012 e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.05.2012)

(1) Pas çdo vizite, Avokati i Popullit përgaditë raport i cili mund të përmbajë rekomandime dhe propozime me qëllim të përmirësimit të kushteve në lokale nga neni 28 ose trajtim të personave të vendosur atje, si dhe parandalimin e ndëshkimit, torturës dhe veprimeve tjera mizore, nënçmuese dhe johumane.

Politika nacionale për mekanizmin parandalues për represalje

ZBULIMET TONA PËR REPRESALJE NË VITIN 2017 DHE 2018 JANË KËTO NË VIJIM:


- Shkelja e të drejtës për korrespondencë të fshehtë;
- Transferimi në burg tjetër si sanksion i padefinuar pas kontaktit me mediumet ;
- Torturë gjatë orëve të natës nën maskën e kërkimit dhe konfiskimit;
- Mungesa e mbrojtjes adekuate gjyqësore në rast të sanksioneve disiplinore.

SHKELJA E TË DREJTËS PËR KORRESPONDENCË TË FSHEHTË

- Në nenin 75 (2) të rregullores për zbatimin e EPRCA vërtetohet se "Shkresat dhe dërgesat e pranuar dhe të dërguara nga të dënuarit do të kontrollohen për mbrojtje të sigurisë dhe parandalim të kriminalitetit dhe futjes së gjësendeve, lëndëve dhe substancave të paautorizuara. Shkresat në formë të shkruar nuk do të jenë lëndë e inspektimit".
- Megjithatë, kjo është në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 75 (4) të Rregullores, në të cilin thuhet se "Në rast të të dhënave nga të cilat mund të supozohet me arsye se shkresa ka përmbajtje që mund të pengoj zbulimin ose të shpie tek kryerja e veprave serioze penale, për të njejtën do të njoftohet udhëheqësi i burgut dhe prokurori i cili do të e shqyrtojë lighshmërinë e vendit të ekzekutimit të dënimit".

MPN i rekomandon ministrin të drejtësisë që të e zgjidhë këtë keqkuptim në nenin 75 (4) të rregullores për zbatimin e EPRCA, me ç'rast nga i njejtë kërkoi edhe interpretim. MPN nuk morri përgjigje. Megjithatë, me ndryshimet ligjore të nenit 86 (3) EPRCA që ishin propozuar dhe miratur (Gazeta e zyrtare nr.13/2017 e cila ka hyrë në fuqi nga data 7 shkurt në vitin 2017), korrespondenca e të burgosurve nuk do të jetë lëndë e monitorimit në lidhje me përmbajtjen e shkresës, përveçse nëse ajo nuk është e nevojshme për zbulimin ose pengimin e veprave të rënda penale.

Në këtë kuptim, ajo është edhe Vendim nr.4 i datës 18 prill të vitit 2006 për Lëndën kushtetues nr.11 i datës 2005 (Gazeta zyrtare nr.36 nga 2 maj i vitit 2006). Gjykata kushtetuese konsideron se që të jenë në përputhshmëri me Kushtetutën, zbardhja e msheftësisë së korrespondencës patjetër duhet që tërësisht të i plotësojë kërkesat për kufizimin e asaj të drejte,



të verifikuar me nenin 34 (2) nga ligji themelorë i Republikës së Bullgarisë. Heqja dorë nga msheftësia e korrespondencës është e pranueshme vetëm me akt të organit gjyqësor.

Transferimi në burg tjetër si sanksion i padefinuar pas kontaktit me mediumet

Gjatë inspektimit të burgut në Burgas në vitin 2018 dhe takimeve me personat e intervistuar, MPN morri ankesa nga të burgosurit për maltretim nga ana e ndihmësve mjekësorë. Një i burgosur n'a njoftoi se ai ka qenë i suspenduar si larës rrobash për arsye mjekësore, sipas vlerësimit të ndihmësit mjekësorë, megjithëse të njëjtën punë ai e ka punuar në burgun e Plovdivit por mjeku nuk ka qenë në dijeni për ate.

MPN konsideron se nëse mjeku punon në burg, duhet që të e zbatojë vlerësimin shëndetësor të të burgosurve. Një i burgosur n'a njoftoi se është penguar që të kryej intervenim mjekësorë për shkak të dokumentit të gabuar i cili ka qenë i lëshuar nga ndihmësi mjekësor. Inspektimi tregoi se nga zyra e prokurorit i kanë sugjeruar administratës së burgut që të e hetojë rastin.

Një i burgosur, në sanatoriumin e mëparshëm, ka parashtruar një numër të ankesave për keqpërdorime dhe shkelje nga ana e mjekut në qendrën medicinale të burgut. Ai ka dorëzuar dokumente relevante në mbështetje të akuzave të cilat i paraqiti. Pastaj, MPN verifikoi se ky person është transferuar nga burgu në Burgas në shtëpinë e burgut.

Pas disa inspektimeve, ekipi zbuloi se është përditshmëri që të burgosurit të ankohen se administrata e burgut i transferon në shtëpinë e burgut në Debelt. MPN i verifikoi këto aktivitete të administratës si represion të maskuar administrativ dhe insiston për ndërprerje të kësaj praktike. I burgosuri B.M ka tentuar që të vetëvritet në burgun hostelik të Debelit në shenjë proteste kundër transferimit..

Torturë gjatë orëve të natës nën maskën e kërkimit dhe konfiskimit

MPN verifikoi raste se në të kaluarën prokuroria dhe organet kompetente të MPB së bashku realizonin kërkime dhe konfiskime të gjësendeve. Këto aktivitete ishin paraqitur si të suksesshme, meqenëse ishin konfiskuar telefona, tableta dhe gjësende tjera të paautorizuara. Mendimi i MPN është se kërkimet e këtilla sipas kodit penal janë të pranueshme në vendin e fjetjes, por jo edhe në të gjithë burgun. Monitorimi në bazë të ligjit nuk do të thotë se MPB mund të hyjë në burgje për kërkime. MPN verifikoi se kjo praktikë është ndërprerë.


- Megjithatë administrata shtetërore gjatë natës kryen kërkime dhe konfiskime të gjësendeve të paautorizuara. Kjo supozohet se kryhet sipas dispozitave të rregullave për zbatimin e EPRCA, për të cilat MPN konsideron se janë joligjore, respektivisht nenit 86 paragrafi 2, që lejon kërkimet dhe konfiskimet të kryhen në çdo kohë gjatë ditës apo natës. Dispozita është në kundërshtim me nenin 84, paragrafin 1, pikën 2 nga EPRCA që parashihet të drejtë të vazhdimet të kohës së fjetjes prej 8 orëve në periudhën 24 orëshe.
- Drejtoria e përgjithshme për ekzekutimin e sanksioneve mendon se "këto aktivitete të gardianëve të burgut janë raste individuale kur me të vërtetë është paraqitur nevoja".
- MPN sugjeron se aktivitetet e gardianëve të burgut janë rezultat i urdhëresës joligjore të drejtorit të burgut, duke vepruar sipas dispozitës joligjore të rregullores për zbatimin e EPRCA. Prandaj, MPN pret reagim të ministrit të drejtësisë i cili e ka lëshuar aktin joligjor.



Mungesa e mbrojtjes adekuate gjyqësore në rast të sanksioneve disiplinore

Në pajtim me nenin 111 të EPRCA, urdhëresa me të cilën shqiptohet izolimi disiplinorë është lëndë e ankesës në gjykatën administrative e cili është kompetente për sferën në të cilën gjendet burgu në afat prej tri ditëve nga shpallja. Ankesa nuk e anulon zbatimin e urdhëresës, përveç nëse gjykata nuk vendos ndryshe. Në ato raste gjykata e shfuqizon urdhëresën si joligjore, ndërsa sanksioni tanimë është ekzekutuar.

- Është e mundur që përsëri me urdhëresë të gjykatës për sanksionet ardhëshme disiplinore të llogaritet koha e kaluar ose të kompenzohet finansiarisht.
- MPN konsideron se kjo urdhëresë duhet të ndryshohet.
- Sipas procedurave dhe dispozitave administrative sanksionet e tjera disiplinore janë lëndë e ankesës. Për shkak të mungesës së ndalesës të qartë për ankimim të sanksioneve të shqiptuara drejtpërdrejtë nga gjykata, praktika gjyqësore e gjykatave regjionale është kundërthënëse. Disa konsiderojnë se aktiviteti është i papranueshëm, ndërsa të tjerë e shqyrtojnë ankesën për ate se a ka bazë në pajtim me nenin 120 paragrafi 2 nga Kushtetuta.
- Gjykatat administrative konsiderojnë se urdhëresat për shqiptimin e sanksioneve disiplinore nuk janë akte administrative, por janë aktivitete për mirëmbajtjen e rendit dhe disiplinës. Disa panele gjyqësore nuk e shqyrtojnë natyrën e këtyre akteve, por supozojnë se janë në kundërthënie dhe përveçse nëse nuk janë të verifikuara qartazi, këto sanksione janë lëndë e ankesës administrative dhe për ate janë të papranueshme.
- MPN konstatoi mungesë të mbrojtjes adekuate gjyqësore dhe rregullimit juridik të praktikës së shqiptimit të sanksioneve disiplinore ndaj personave të privuar nga liria. Kjo i sqaron rastet e numërta të drejtuarit e Avokatit të Popullit për kompetencat e tij, sipas nenit 100, në lidhje me nenin 99 nga APC për eliminimin e shkeljeve, siç sugjerojnë raportet e inspektimit.



Maja Kević

Zëvendëse e Avokatit të popullit të Republikës së Kroacisë

Republika e Kroacisë ratifikoi OPCAT më 5 Prill 2005 dhe në këtë mënyrë u angazhua për krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Parandalues.

Në përputhje me nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Kroacisë, Avokati i Popullit fuqizohet nga Parlamenti Kroat për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut dhe lirinë e përcaktuar në Kushtetutë, ligje dhe akte juridike ndërkombëtare të miratuara nga Republika e Kroacisë. Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2008, Bordi Koordinues Ndërkombëtar për Institucionet Kombëtare i dha Avokatit të Popullit "statusin A" për të qenë një institucion për mbrojtjen e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, i cili është statusi më i lartë i caktuar një institucioni për të drejtat e njeriut i cili plotëson kriteret e të ashtuquajturave Parime të Parisit. Vitet 2013 dhe 2019 riafirmuan "statusin A" i cili çoi në ndryshime të rëndësishme dhe rrit ndikimin e institucionit, kryesisht duke aplikuar standarde ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në një nivel kombëtar dhe lokal dhe duke raportuar para organeve ndërkombëtare, përfshirë dhe UPR proces.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, si dhe faktin që Avokati i Popullit ka vizituar rregullisht vendet ku mbaheshin persona të privuar nga liria në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, më 28 janar 2011, Parlamenti Kroat miratoi Ligjin për Mekanizmin Parandalues Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe një lloji tjetër trajtimi apo dënimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues (LMKP) i cili përcakton që aktivitetet e MKN-së do të kryhen nga Avokati i Popullit.

Në Prill 2015, ndryshimet dhe plotësimet në LMKP hynë në fuqi. Ndryshimet më domethënëse janë, natyrisht, ato me të cilat pjesëmarrja e dy përfaqësuesve të komunitetit akademik dhe dy përfaqësuesve të shoqatave në zbatimin e aktiviteteve të MPN-së, zëvendësohet me bashkëpunim me një numër shoqatash dhe ekspertësh të pavarur, dhe parashikohet shprehimisht mundësia e bashkëpunimit me avokatë speciale femra.

Nga viti 2012 deri në vitin 2018 kemi kryer 210 vizita nga të cilat janë dërguar 188 vizita të rregullta dhe 22 kontrolle, 1362 rekomandime dhe 215 paralajmërime. Gjatë kësaj periudhe,



ne kemi kryer 113 vizita në komisarate dhe njësi paraburgimi, 43 vizita në burgje dhe institucione ndëshkimi, 14 vizita në institucione psikiatrike, 17 vizita tek azilkërkuesit dhe migrantë të parregullt, 13 vizita në shtëpi për të moshuarit dhe persona me aftësi të kufizuara, 5 vizita në institucione sociale dhe 5 vizita në kazemat ku ndodhen ambientet e ndalimit dhe privimit të lirisë.

Gjatë vitit 2018 kemi realizuar 25 vizita në komisarate, për të cilat kemi dërguar 64 rekomandime dhe katër paralajmërime, gjashtë vizita në burg, për të cilat kemi paraqitur 58 rekomandime dhe 27 paralajmërime, dy vizita në institucionet psikiatrike, për të cilat kemi paraqitur 27 rekomandime dhe tre paralajmërime, gjashtë vizita për aplikantët për mbrojtje ndërkombëtare dhe migrantë të parregullt ku kemi dhënë 36 rekomandime dhe dy paralajmërime, tre vizita në shtëpi për persona të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, ku kemi paraqitur 60 rekomandime dhe nëntë paralajmërime dhe kemi vizituar një shtëpi për të rritur me sëmundje mendore, ku kemi dhënë pesë rekomandime dhe tre paralajmërime.

Në vitin 2018 zbuluam që mbikëqyrja civile e policisë nuk ishte vendosur akoma dhe se kishte pasur keqpërdorim të autorizimit të dhënë nga oficerët e policisë në momente kur përdoret forcë, mungesë hetimesh efektive dhe të pavarura për paditë që kanë të bëjnë me tejkalimin e autorizimeve, edukim të pamjaftueshëm të oficerëve të policisë për të drejtat njerëzore, veçanërisht gjatë kryerjes së detyrave të tyre policore dhe zbatimit të autoritetit të tyre në grupet e cënueshme të synuara, mungesa e vëzhgimit me video të personave të privuar nga liria dhe kushte joadekuate për akomodimin e tyre.

Sa i përket sistemit të burgjeve, kemi gjetur qasje të pamjaftueshme në kujdesin adekuat shëndetësor, kushte të papërshtatshme të strehimit, personel të pamjaftueshëm, përfshirë mjekë dhe infermierë / teknikë, trajtim të pabarabartë, efikasitet të pamjaftueshëm të mjeteve juridike, dhunë ndër të burgosurit.

Në institucionet psikiatrike gjetëm kushte për akomodim të papërshtatshëm me standartet ndërkombëtare, edukim të pamjaftueshëm për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mendore, mungesë të regjistrave për zbatimin e masave shtrënguese, ndërsa për migrantët, ne gjetëm joefektivitetin e pretendimeve për dënim kolektiv të migrantëve nga përdorimi i mjeteve të dhunshme, mungesa e vetëdijes së migrantëve për të drejtat e tyre. Ne gjithashtu kemi zbuluar se disa migrantë nuk kanë qasje në mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Kroacisë.


Prezantimi i këtyre shifrave dhe gjetjeve tregon shtrirjen e punës së bërë nga Mekanizmi Parandalues Nacional, pra fushëveprimi i personave që kryejnë intervista në interes të përmbytjes së mandatit siç përcaktohet në OPCAT.

Megjithatë LMKP nuk rregullon çështjen e parandalimit të ndëshkimit, ratifikimi i OPCAT vlen për nenin 21 i cili thotë: "Asnjë organ dhe as zyrtar nuk mund të urdhërojë, aplikojë, lejojë ose tolerojë ndonjë sanksion ndaj ndonjë personi ose organizate për zbulimin e ndonjë informacioni për MKP, qoftë e rreme apo e vërtetë, dhe asnjë person apo organizatë e tillë nuk mund të rrezikohet në asnjë mënyrë".

Në fillim të funksionimit të MKP-së, u dha informacione me shkrim ministrive dhe institucioneve kompetente të mandatit të tij, përfshirë detyrimin e Shtetit sipas nenit 21 të OPCAT.

Detyrimet e përcaktuara në OPCAT përcaktohen në takime të rregullta me institucionet shtetërore, njoftime publike dhe ngjarje të tjera për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me ndalimin e çfarëdo forme të ndëshkimit për personat që ofrojnë informacion konfidencial për MKP. MKP gjithashtu zhvillon arsim për policët dhe oficerët e burgjeve.

Është e rëndësishme të theksohet se deri më tani nuk kemi pasur ankesa ose njohuri për dënime të mundshme gjatë ose pas vizitave të MKP-së, por kemi pasur një rast që një i burgosur të ndëshkohet në 2009 kur MKP ende nuk ishte krijuar në Republikën e Kroacisë. Në atë rast, i burgosuri iu ankua Avokatit të Popullit për mungesën e kujdesit shëndetësor në burg, dhe për shkak të përmbajtjes së ankesës autoritetet e burgut filluan një procedurë disiplinore



për dhënien e informacionit të rremë.

Avokati i Popullit në këtë rast paralajmëroi autoritetet e burgut dhe Ministrinë e Drejtësisë që ankesat e të burgosurve te Avokati i Popullit, pavarësisht nga bazat e pohimeve, nuk duhet të interpretohen si shpifëse, dhe as nuk duhet të fillohet ndonjë procedurë disiplinore ndaj ankesit për shkak të pikëpamjeve të shprehura në çështje. Në të njëjtën mënyrë, indikacioni i të burgosurit për mundësinë e fillimit të një procesi penal nuk ishte vetëm i dyshimtë juridikisht në çështjen e përmendur, por ishte padyshim një formë e frikësimit dhe e pengonte të burgosurin të paraqiste një ankesë.

Ministria kompetente më pas u dërgoi udhëzime të gjitha qendrave të paraburgimit, burgjeve dhe institucioneve korrektuese-dënuese duke thënë se procedurat disiplinore kundër të burgosurve shkak i paraqitjes së ankesave do të jenë të papranueshme.

Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes nga ndëshkimi, në rrjedhojë është zhvillimi i një Metodologjie të re të Punës, e cila në Kapitullin 8, mbulon shtjellimin e nenit 21 të OPCAT.

Ky kapitull paraqet qasje parandaluese dhe reaktive ndaj veprimit, në varësi të faktit nëse ka ndodhur një dënim i veçantë ose nëse jemi të vetëdijshëm për dënimin e mundshëm. Theksi është në një qasje parandaluese që duhet të parandalojë ndëshkimin, kështu që gjatë vizitës, përfaqësuesit e MPN-së prezantojnë zyrtarë dhe persona të privuar nga liria me ndalimin e ndëshkimit dhe mundësinë e raportimit në zyrën e Avokatit të Popullit.

Për më tepër, thuhet se nëse gjatë vizitës së MKP-së ka informacione për dënimin e mundshëm, personi udhëheqës do të informohet menjëherë për dënimin, do të paralajmërohet për dënimin dhe do t'i jepet një paralajmërim me shkrim në formën e një raporti të MPN-së. Një vizitë ad hoc kryhet nëse ekziston informacioni se një person është ndëshkuar ose ekziston një tregues serioz që personi do të ndëshkohet.

Rekomandohet gjithashtu që MPN të jetë në gjendje të kryejë një vizitë kontrolli pas vizitave të rregullta ose ad hoc në organet ndërkombëtare për parandalimin e torturave ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese me kusht që të jetë i vetëdijshëm për ndëshkimet e mundshme.

Draft Metodologjia gjithashtu përfshin një qasje reaktive në rast të ndëshkimit ekzistues të një personi ose organizate pas bisedës me MPN. Nëse merret një informacion i tillë, një hetim urgjent zhvillohet nga zyra e Avokatit të Popullit. Nëse autoritetet shtetërore kompetente nuk respektojnë ndalimin e ndëshkimit, MPN do të informojë ministritë kompetente si dhe organet ndërkombëtare për parandalimin e torturave ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

Duke u nisur nga objektivi kryesor i Rrjetit për Shkëmbim të Përvojave dhe mbështetje e ndërsjellë në zbatimin e mandatit të mekanizmave kombëtar parandalues, shpresojmë që do të miratohet një strategji dhe metodologji për të mbrojtur individët ose organizatat nga çdo formë e ndëshkimit, dhe mandati do të zbatohet pa asnjë kufizim.



Hrisulla Antoniu

**Hulumtuese speciale, Avokati
i popullit Greqi**

Korniza ligjore vendore


Tejkalimi i hendekut midis stadardeve të paraburgimit ose burgimit dhe praktikës është një sfidë për MPN-në. Kapaciteti për të parandaluar në mënyrë efektive torturën dhe keqtrajtimet e tjera mund të dëmtohet kur ankuesit frikësohen ose kur paragjyken. Të përkujtohemi në frazën e mirënjohur “Në qoftë se heshtet zëri i tyre, puna jonë për të drejtat e njeriut do të bëhet gjithashtu viktimë⁵”. Nuk ka dyshim se politika efektive për reprezalje forcohet nga legjislacioni i fortë i brendshëm që paraqet, pak a shumë, një sistem transparent në lidhje me vendet e privimit të lirisë. Në pjesën e parë të këtij prezantimi, do të prezantohet një aspekt konciz i legjislacionit vendor për entet ndëshkuese-korrektuese me qëllim që të shqyrtohet korniza ligjore dhe masat mbrojtëse procedurale të cilat e nxisin politikën e MPN-së të Greqisë në lidhje me hakmarjen.

Siç theksoi në mënyrë eksplicite KPT-ja në raportin e tij të përgjithshëm të fundit⁶, politika proaktive lidhur me parandalimin e torturës ndaj personave të privuar nga liria përfshin tre dispozita kyçe: e drejta për qasje deri te avokati, e drejta për qasje pranë mjekut, e drejta për të njoftuar familjarët - ose palën tjetër të tretë - për faktin e paraburgimit. Duke ndjekur këtë “triniteti i të drejtave”, do të përpiqemi që në mënyrë përkatëse t’i ndjekim dispozitat e së drejtës vendore që i mundësojnë personit të paraburgosur ose të burgosur t’i shfrytëzojë këto të drejta: ndihmën juridike, kontrollin mjekësor, komunikimin e papenguar.

Për më tepër, informimi i të burgosurit për të drejtat e tij/saj, kontrolli i të gjitha masave nga ana e organit ligjdhënës ose organit tjetër, e drejta për të paraqitur, ruajtja e konfidencialitetit dhe paanshmërisë gjatë hetimit të ankesave mund të shtohen në ato parametra të cilat ndihmojnë në zvogëlimin e shkaqeve sistematike të cilat lejojnë sjellje arbitrare. Të gjitha

⁵ Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Nju Jork, viti 2011

⁶ KPT/Info (2019) pjesa e 9-të, paragrafi 2/4, , §66,28 raporti i përgjithshëm i KPT-së.



masat e lartpërmendura të kujdesit duhet të jenë në pajtueshmëri me supozimin se frikësimi ose hakmarja mund të jenë rezultat i akteve ose mosveprimit nga ana e bartësve shtetëror dhe joshetëror, sipas Udhëzimit të Kombeve të bashkuara kundër frikësimit ose reprezaljeve ("Udhëzime San Hose").

Personi i burgosur mund të paraqet raport pranë Këshillit të burgut për keqtrajtim ose kërkesë jolegjitime nga ana e personelit të burgut.

Në qoftë se Këshilli i burgut e refuzon kërkesën ose nuk jep përgjigje brenda afatit prej një muaji, i burgosuri ka të drejtë të paraqes ankesë pranë Këshillit gjyqësor lokal. Seksioni kompetent i Ministrisë për drejtësi, i autorizuar për të shqyrtuar funksionin përkatës të hapësirave për paraburgim, gjithashtu është i autorizuar me mandat të ndjek respektimin e drejtë të administratave ndaj vendimeve të gjykatës së lartpërmendur.

Në çdo rast, ankesa e të burgosurit e dërguar pranë organit publik ose organizatës ndërkombëtare medoemos duhet dërguar në afat prej tre ditëve, pa kurrfarë kontrolli ose censurimi të përmbajtjes së saj nga ana e drejtorisë së lokaleve. Sekreti i komunikimit është kryesisht i mbrojtur sipas dispozitave të ENK-së, edhe pse kontrolli i përmbajtjes së komunikimit mund të zbatohet për shkaqe sigurie ose me qëllim të hetimit të krimeve veçanërisht të rënda.

Në kontekstin e njëjtë, organi kompetent gjyqësor, i cili është në këtë rast, prokurori publik mbikëqyrës i hapësirës për paraburgim, është i autorizuar të mbikëqyrë kushtet dhe legjitimitetin e kufizimeve në burg. Për shkak se burgu ka për detyrë të sigurojë sigurinë për çdo të burgosur, një viktimë e shqetësimit ose dhunës mund t'i drejtohet prokurorit publik mbikëqyrës, drejtorit dhe cilit do anëtarë të personelit të burgut, si rojtarit kryesor, psikologut, sociologut ose punonjësit social. Për këtë qëllim, pranohet se kërcënimet, gjithashtu, paraqesin akt të dhunës dhe shqetësimit⁷. Ако затворено лице е ограничено од прифаќање на посети, тој/таа може, исто така, тоа да го пријави и на надзорниот јавен обвинител.

Personi i burgosur mund të paraqet raport pranë Këshillit të burgut për keqtrajtim ose kërkesë jolegjitime nga ana e personelit të burgut. Në qoftë se Këshilli i burgut e refuzon kërkesën ose nuk jep përgjigje brenda afatit prej një muaji, i burgosuri ka të drejtë të paraqes ankesë pranë Këshillit gjyqësor lokal. Seksioni kompetent i Ministrisë për drejtësi, i autorizuar për të shqyrtuar funksionin përkatës të hapësirave për paraburgim, gjithashtu është i autorizuar me mandat të ndjek respektimin e drejtë të administratave ndaj vendimeve të gjykatës së lartpërmendur.

Në çdo rast, ankesa e të burgosurit e dërguar pranë organit publik ose organizatës ndërkombëtare medoemos duhet dërguar në afat prej tre ditëve, pa kurrfarë kontrolli ose censurimi të përmbajtjes së saj nga ana e drejtorisë së lokaleve. Sekreti i komunikimit është kryesisht i mbrojtur sipas dispozitave të ENK-së, edhe pse kontrolli i përmbajtjes së komunikimit mund të zbatohet për shkaqe sigurie ose me qëllim të hetimit të krimeve veçanërisht të rënda.

Mëtej, personi i burgosur mundet të deklarohet me shkrim nëse siguria e tij është në rrezik dhe nëse ka nevojë për mbrojtje ose ka të burgosur me të cilët ka probleme. Përveç kësaj, personi i paraburgosur mundet me shkrim të kërkojë që të transferohet në vend tjetër të paraburgimit për arsye personale.

Gjatë kohës së procedurës disiplinore, personi i paraburgosur ka të drejtë të informohet me shkrim për kundërvajtjen disiplinore për të cilën është akuzuar. Ai/ajo gjithashtu ka të drejtë të thirret para Këshillit disiplinor në afat brenda pesë ditëve prej ditës së miratimit të aktvendimit dhe të kërkojë, që dënimi i kufizimit në një qeli të vetme të pezullohet, ndërpritet ose kursehet.

⁷ Nga A deri në Sh për të burgosurit, Ministria e drejtësisë e Greqisë, transparencë dhe të drejtat e njeriut, Politika kriminale e Sekretariatit të përgjithshëm, 2018



Çdo masë e shqiptuar disiplinore është regjistruar në një procesverbal të veçantë. Asnjë sanksion nuk mund të shqiptohet, nëse vepra nuk është paraparë në ligjin ose rregulloren paraprake dhe nuk mund të shqiptohet dënimi disiplinor nëse ai nuk është i personalizuar. Prania e këshillit juridik të të burgosurit është gjithashtu e arritshme për kundërvajtjet më të rënda disiplinore.

Personi i privuar nga liria ka të drejtë absolute dhe të pakontestueshme për të komunikuar me avokat⁸. Ndihma juridike do të sigurohet për të burgosurit e vobektë, pasi që do të parashtrahet kërkesa pranë prokurorit publik mbikëqyrës. Përveç kësaj, sipas pëlqimit të të burgosurit, i cili është shtetas i huaj dhe i cili medoemos duhet të jetë i informuar për të drejtat e tij për gjuhën të cilën e kupton, misioni diplomatik i shtetit prej të cilit ka prejardhjen mund të informohet për faktin e burgosjes së tij.

Detyrat e punonjësve medicinal pritet të kryhen në suaza të disiplinave të pavarura profesionale dhe shkencore. Si rezultat i kësaj, të burgosurit medoemos duhet t'i mundësohen ekzaminime sipas kërkesës së tij dhe me rregull. Personi i burgosur mundet gjithashtu të kërkojë që për kontroll ta mer mjeku i tij personal. Nga personeli i burgut pritet që të njoftojnë mjekun për hapësirën për incidentin eventuale urgjent që ka ndodhur gjatë mungesës së tij në lidhje me shëndetin ose jetën e të burgosurit⁹, ndërsa evidenca e veçantë për viktimat e shqetësimit dhe keqtrajtimit medoemos duhet të udhëhiqet në çdo hapësirë.

Përfundimisht, janë parashikuar dënime të ashpra për dhunë fizike të kryer midis të burgosurve, madje edhe gjatë kohës së pushimit¹⁰, siç është parashikuar me legjislaturën e paradokohshme. Njëherazi, procedurat disiplinore të policisë greke parashikojnë pezullimin e përhershëm të zyrtarëve për zbatimin e ligjit, të cilët kanë kryer aksione duke shkelur rëndë dinjitetin e njeriut¹¹.

Si konkludim, miratimi i të gjitha masave të lartpërmendura procedurale mbrojtëse, së bashku me mandatin e më shumë organizatave të kryejnë kontroll të drejtpërdrejtë në vendet e privimit nga liria¹², japin garanca të caktuara. Por, a është implementimi i tyre përkatës për t'u siguruar se drejtësia nuk ndalet në derën e burgut? Ky është vendi ku roli ynë fillon të zgjerohet dhe plotësojë këtë kornizë me politikën tonë kundër reprezaljeve.


⁸ Kodi i procedurave penale, neni 96

⁹ Vendimi ministror, numri 58819/7.4.2003

¹⁰ Ligji, numri, 4322/2015 neni 5

¹¹ Dekret presidencial, numri 22/1996

¹² Përveç Avokatit të popullit të Greqisë (MPN), vizita të drejtpërdrejta realizohen, nëmes tjerash, edhe nga Organi për inspektim dhe kontroll të Seksionit për paraburgim pranë Ministrisë për drejtësi, transparencë dhe të drejta të njeriut dhe Komisioni i posaçëm i përhershëm parlamentar për sistemin ndëshkues-korrektues dhe forma të tjera për burgosjen e të burgosurve.



Evangelia Markaki

Hulumtuese speciale, Avokati i popullit Greqi

Operacionet e MPN: Përmbledhje e vitit 2018

Rreziku i torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit është kudo, por ky rrezik po rritet në ambiente të mbyllura, në vende jashtë syrit të publikut.

Rreziku i hakmarrjes për personat e privuar nga liria të cilët kanë qenë në kontakt me MPN është një sfidë serioze. **Qëllimi ynë duhet të jetë të eliminojmë - sa më shumë të jetë e mundur - praktikën e dhunshme të paraburgimit.**

Represionet marrin një shumëllojshmëri formash nga kufizimet e panevojshme të të drejtave themelore, ndalimi në kushte më të këqija, kërkimet pushtuese të trupave, sulmet, tërheqje e mbështetjes për lirim të parakohshëm, deri në mbyllje të vetmuar për shkaqe të fabrikuara disiplinore ose sigurie.

Kjo është një detyrë e kërkuar dhe e specializuar **që kërkon frekuentim të rregullt në vendet e paraburgimit, ekspertizë multidisiplinare**, staf të përkushtuar **dhe mjete efektive metodologjike.**

MPN Greke¹³ punon në Institucionin e Avokatit të popullit dhe stafi i specializuar i inspektorëve të vjetër kryen detyrat e MPN.

Ekipi ynë përbëhet nga 15 profesionistë nga fusha të ndryshme të ekspertizës, kryesisht juristë, si dhe shkencëtarë socialë dhe psikologë.

Duke pasur parasysh detyrimin ligjor të MPN për të parandaluar torturat dhe keqtrajtimet e tjera dhe të zbatojnë kornizën ligjore dhe udhëzimet e paraqitura më lart, do dëshiroj t'ju paraqes një përmbledhje të shpejtë të aktiviteteve tona të vitit të kaluar, me një fokus në strategjitë dhe praktikën në lidhje me të ndaluarit në sistemin e drejtësisë penale.

¹³ 3Ligji nr. 4228/2014



Viti 2018 ishte një vit i të menduarit strategjik, zhvillimit metodologjik dhe ndërhyrjeve sistematike operative për të mbrojtur të drejtat në regjimet e paraburgimit: (penale, administrative, psikiatrike). Edhe pse nuk kemi akuza të regjistruara për hakmarje, ne po përpiqemi të zhvillojmë strategjinë dhe mjetet tona metodologjike në mënyrë që të mund ta zgjidhim problemin.

Planifikimi themelor i Avokatit të popullit për **vizita të rregullta mujore rajonale** i mundësoi MPN-së që të sistemojë vizitat e tij në terren në vendet e paraburgimit, ndërsa prania e tij në nivel ndërkombëtarë me pjesëmarrje në takime evropiane ose rajonale dhe rrjete u forcua.

MPN Greke ndjek zhvillimet e përditshme në ambientet e paraburgimit dhe gjithashtu ka filluar një seri kontaktesh me Ministrinë përkatëse të Drejtësisë dhe organizatat e shoqërisë civile.

Anëtarët e MPN-së ndjekin procedura specifike kur vizitojnë qendrat e paraburgimit.

Lista e detajuar e kontrollit përdoret si një mjet themelor për të siguruar një qasje të unifikuar.

Metoda e përdorur gjatë vizitave përfshin:

- Biseda me menaxherin e burgut, stafin e burgut dhe aktorët e tjerë të interesuar,
- Biseda me të burgosurit - në grupe dhe individualisht,
- Shqyrtimi i dokumenteve përkatëse administrative dhe regjistrave për rishikim të plotë të sanksioneve disiplinore në lidhje me proporcionalitetin dhe ligjshmërinë e tyre,


Metodologjia e vizitës ka plotësuar, rishikuar dhe pasuruar këtë vit për sa i përket efektivitetit të saj bazuar në standardet ndërkombëtare, si dhe gjetjet e vitit të kaluar.

Si rezultat i vëmendjes së shtuar ndaj këtij fenomeni, ne kemi vendosur të krijojmë një kornizë koherente për veprim dhe të forcojmë mjetet dhe procedurat për t'iu përgjigjur më mirë praktikave të mundshme të hakmarrjes.

Kështu që, metodologjia e vizitave u përmirësua duke pilotuar mjete dhe praktika të reja që përgjithësisht u gjetën të dobishme.

në veçanti:

- **Kohëzgjatja** e vizitave të tilla pilot (fillimisht të kryera në 3 qendra paraburgimi) ishte **shtrirë në 2 ditë**, me qëllim që të merrte më shumë kohë me stafin dhe të paraburgosurit dhe të ekzaminoni më hollësisht kushtet.
- Dy lloje **të pyetësorëve** anonimë (**për të mitur dhe të rritur**) për plotësimin vullnetar nga të burgosurit u shpërndanë dhe u mbledhën në ditën e parë të vizitës sonë. Shpjegimet për pyetësorin e përkthyer në gjuhët më të zakonshme (sipas të dhënave të kombësisë për të arrestuarit të marra nga statistikat nga Ministria e Drejtësisë) u janë dhënë të ndaluarve. Së bashku me një seri çështjesh të përqendruara në kushtet e paraburgimit, p.sh. **një ndjenjë e sigurisë/incidenteve të mundshme të dhunës/dhe aksesit në shërbime ose aktivitete**, gjithashtu ka një hapësirë ku të arrestuarit mund të shtojnë ndonjë koment tjetër në lidhje me ndalimin e tyre. Të arrestuarit ishin të përzemërt dhe iu përgjigjën mirë kësaj procedure. Përpunimi i mëtutjeshëm i këtyre pyetësorëve pilot i dha MPN Greke burime më të gjera informacioni mbi kushtet e paraburgimit, ndërsa materiali i mbledhur u përdor në kontekstin e ndërhyrjeve të synuara dhe në të njëjtën kohë lehtësoi rivlerësimin e vetë pyetësorit.



- Teknika për të rritur ndjenjën e konfidencialitetit janë përdorur **në diskutime të hapura** me të arrestuarit për të inkurajuar individë ose grupe të individëve të raportojnë akte të mundshme të frikësimit ose hakmarrjes pa u frikësuar.
- Përveç bisedave të hapura, intervistat individuale **(me një ekzemplarë të rastësishëm dhe përfaqësues, si dhe secilin që shprehu gatishmëri për ta bërë këtë)** u zhvilluan nga anëtarët e MPN-së në një dhomë të veçantë, pa asnjë staf burgu të pranishëm, në mënyrë që të zvogëlonte rrezikun nga hakmarrja e mundshme.

Në 2018, MPN Greke filloi një praktikë inovative **të hetimit të incidenteve që përfshijnë vdekjen ose dëmtimet e të arrestuarve**, të vetë-dëmtuar ose për shkak të përgjigjes së pamjaftueshme/të papërshtatshme nga stafi i burgut, si dhe për incidente të tilla si rezultat i dhunës midis të ndaluarve. MPN-ja më pas vepron me iniciativën e vet (kështu pa raportuar) dhe kërkon informacion nga Ministria e Drejtësisë dhe qendra përkatëse e paraburgimit për të hetuar plotësisht rrethanat në të cilat ndodhën këto incidente. Hetimi i incidenteve të mësipërme gjithashtu mund të zbulojë akte hakmarrjeje.

- Për më tepër, mandatet speciale të Zyrës së Avokatit të Popullit, duke vepruar si një Organ i Monitorimit të Jashtëm për kthimin e detyruar të shtetasve të vendeve të treta, si dhe emërimin e tyre për të vepruar si një Mekanizëm Kombëtar i Hetimit të Incidenteve Arbitrare (NMIAI)¹⁵ **(shqyrton incidente mbi abuzimin e kompetencave të trupave të zbatimit të ligjit) i dha ekipit MPN mundësinë për të marrë informacion të vlefshëm dhe të punojë në mënyrë plotësuese me kolegët për çështje që lidhen me keqtrajttime.**

Përveç të lartpërmendurës:

- Ekipi i MPN gjithashtu merr pjesë aktive në debate publike, duke kontribuar në tërheqjen e vëmendjes ndaj realitetit të ndalimit jo vetëm të autoriteteve, por edhe të mediave dhe shoqërisë civile.
- Raportet e MPN-së (raportet e vizitave, raportet vjetore, raportet tematike dhe përcjellëse) mund të shihen si një mjet kryesor për transparencën, përgjegjshmërinë dhe ndërgjegjësimin e punës së MPN-së në mandatin e përgjithshëm dhe çështje specifike.

Vështirësitë

Megjithë përparimin e bërë nga Mekanizmi Parandalues, sfida të shumta ende vazhdojnë.

Anëtarët e MPN përballen me një numër vështirësish që mund të dëmtojnë aftësinë e tyre për të parandaluar në mënyrë efektive keqtrajtimin.

Përmendur shkurtimisht:

Mungesa ose alokim i pamjaftueshëm i burimeve:

- a) stafi (pra mungesa e burimeve njerëzore, gjithashtu mungesa e disa fushave të ekspertizës, p.sh. mjekët, ekspertët e shëndetit mendor),
- b) në kohë (lufta për balancimin e duhur të të gjitha mandateve),

¹⁴ Ligji nr.. 3907/2011, neni23

¹⁵ Ligji nr.4443/2016, neni 56




Mjetet efektive të hakmarrjes duhet të zhvillohen më tej për të adresuar çekuilibrin e pushtetit midis stafit të burgut dhe të burgosurve dhe pretendimet e mosbesimit të të burgosurit në emër të stafit të burgut.


Hapat e mëtutjeshëm për të luftuar pasojat: Sfida e MPN-së

- Është e qartë se **një pretendim për frikësim ose hakmarrje të mirëfilltë duhet të merret seriozisht, të raportohet dhe të përgjigjet.**
- Çështjet e hakmarrjes të marra nën mandatin tonë të përgjithshëm ose Mekanizmin Arbitror të Hetimit të Incidenteve për të dokumentuar dhe mirëmbajtur një bazë të dhënash.
- Të prezantohet një raport tematik mbi çështjet e hakmarrjes.
- Monitoroni raste të raportuara.
- Për të evoluuar mjetet metodologjike, p.sh. duke zhvilluar një pyetësor specifik për masat mbrojtëse, duke zgjatur kohëzgjatjen e vizitës, etj.
- Të ritet gatishmëria për bashkëpunim/për të raportuar dhe zvogëluar ndjenjat e kërcënimit kur bashkëpunoni me anëtarët e MPN-së.
- Të Intensifikohet bashkëpunimi me institucione të tjera, organet monitoruese dhe OJQ- në fushën e parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit.
- Të intensifikojmë bashkëpunimin me forcat shtetërore duke paraqitur propozime legjislative dhe duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve tona.

Si përfundim, mbani në mend se vetë fakti që MPN ka **fuqinë për të hyrë, në çdo kohë, në çdo vend** ku personat privohen nga liria e tyre, është një përparim i rëndësishëm në vet-vete, duke pasur një efekt të mrekullueshëm në abuzime dhe kontribuon në rritjen e transparencës në vendet e ndalimit.

Epilog:





(Fotografia e marrë në punëtorinë e gdhendjes gjatë vizitës sonë në Qendrën e Paraburgimit në Kretë, shkurt 2018)

*Mos kërkoni të mësoni
gjëra që nuk duhen thënë
dhe nëse mësoni mos thoni
sepse do të vuani kaq shumë...*



Kristina Izso dhe Istvan Sarkozy

Këshilltarë juridik më të vjetër në OPKAT MPN Otsek, Hungari

Fusha ligjore dhe praktika e përgjithshme


Në Hungari, Akti CXI nga viti 2011 për Komisionerin për të Drejta Themelore (në tekstin në vijim "Akti i Avokatit të Popullit") i përkufizon kompetencat e Komisionerit për të Drejtat Themelore. Sipas nenit 21 (1) të Ligjit për Avokatin e Popullit, Komisioneri mund të kërkojë të dhëna dhe informata nga organi inspektues, ta thërret kryeshefin e organit, të marr pjesë në diskutimin publik ose dëgjim dhe të zbatojë këqyrje aty për aty.

Komisioneri për të Drejtat Themelore mund të veprojë në kuadër të MPN-së. Kapitulli III/A i Ligjit për Avokatin e Popullit i përmban këto masa dhe procedura. MPN-ja mund të kërkojë të dhëna, informata dhe kopje të dokumenteve relevante nga organi i autorizuar. Ai mund ta ftojë shefin e organit ose kryeshefin e organit të tij mbikëqyrës të zbatojë hetim. Ai, gjithashtu, mund të marr pjesë në diskutim ose debat publikë dhe të kryej këqyrje aty për aty.

Gjatë inspektimit në terren, Komisioneri për të Drejtat Themelore mund ta dëgjojë çdo person të pranishëm në tryezë, përfshirë edhe personelin e organit kompetent i cili është nën inspektim dhe çdo person të privuar nga liria e tij. Në këto seanca asnjë person tjetër nuk mund të marr pjesë, përveç nëse MPN-ja nuk e autorizon pjesëmarrjen e tij. [Ligji për Avokatin e Popullit, Pjesa 39 / B (3) - (4)].

Pjesa 39 / E të Ligjit për Avokatin e Popullit parashikon se askush nuk mund të vuajë asnjë pa-favoritet për shkak të dhënies së informatave tek Komesari për të Drejtat Themelore ose tek anëtarët dhe personelit të tyre/të saj, të autorizuar që t'i kryejnë detyrat që lidhen me MPN.

Në fillim të çdo vizite, MPN në letrën e komisionit në mënyrë eksplicite vë në dukje nenin 21 (1) të OPKAT, sipas të cilit asnjë organ ose person zyrtar nuk mund të urdhërojë, kryejë, lejojë ose tolerojë ndëshkim kundër cilitdo qoftë person ose organizatë për raportim dhe informim tek Mekanizmit Parandalues Nacional, pavarësisht se a është i vërtetë ose jo informacioni, dhe asnjë person i këtillë ose organizatë nuk guxon t'u nënshtrohet paragjyqimeve të çfarëdo qoftë mënyre.



Pjesa hyrëse e raporteve për MPN vëmendjen e drejton tek neni 21 (1) i OPKAT si aspekt i rëndësishëm që duhet të merret parasysh.

SPT qëndroi në vizitë në Hungari midis datës 21 dhe 30 mars të vitit 2017. Në rekomandimet e tij, SPT vuri në dukje çështjen e konfidencialitetit dhe rrezikut nga hakmarrja.

SPT vuri në dukje se lokacioni ku zhvillohen intervistat individuale duhet të zgjidhet me kujdes në mënyrë që të sigurohet konfidencialiteti i përmbajtjes së intervistës dhe se parimit "mos bën dëm" aplikohet, pa përjashtim. SPT shtoi se të anketuarit gjithashtu duhet të vënë në pah se të anketuarit mund të paraqesin çdo lloj të hakmarrjes me të cilën përballen pas vizitës, madje edhe ti inkurajojnë që ta bëjnë këtë. Nëse është e nevojshme, duhet të zbatohen vizita për rikontroll. SPT e theksoi nevojën që çdoherë duhet të kërkohen mënyra për mbrojtjen e të intervistuarve nga hakmarrja e mundshme, madje edhe kur duket se ekziston një rrezik i vogël.

SPT i rekomandon MPN që çdoherë të llogarisë se ekziston rrezik nga frikësimi, sanksionet ose hakmarrjet, dhe për këtë shkak të ndërmerr hapa për zgjidhjen e këtij rreziku. MPN qartë duhet ti njoftoj autoritetet se hakmarrja e çdo lloj është e papranueshme dhe se do të kallëzohet dhe përcillet nga MPN. Gjithashtu, MPN duhet të kryej vizita parandaluese.

Të punësuarit në MPN të cilët i intervistojnë të paraburgosurit e zgjedhin me kujdes lokacionin e intervistave, kështu që zbatohet principi i konfidencialitetit. Të paraburgosurit informohen se pjesëmarrja në intervistë është vullnetare, nuk evidentohen të dhënat personale. Të punësuarit në MPN përpiqen të zhvillojnë intervista private me të paraburgosurit, gardianët duhet të mbeten jashtë vendit ku zhvillohet dëgjimi.

MPN, gjatë vizitave të tij, gjithmonë fokusohet në mekanizmin e ankesave. Metoda më efektive për parandalimin dhe ndërprerjen e veprimit të keq është se, të punësuarit në vendin e paraburgimit informohen sa më shpejtë të jetë e mundshme dhe i analizojnë ankesat e këtilla. Duke e marrë parasysh se të paraburgosurit janë të ekspozuan ndaj represalieve, është me rëndësi që ata të kenë mundësi të ankohen në mënyrë anonime. Personeli i MPN i analizon mundësitë e mekanizmit për ankesa, përkatësisht se si të paraburgosurit mund të formojnë një ankesë dhe si institucioni i analizon parashtresat e këtilla.

Në qoftë se ka ndonjë veprim i cili duhet të ndërmerret menjëherë, vizita e delegacionit ua vë në dukje administratorëve vendin e vizituar të paraburgimit për këto probleme në brifingun e fundit.

MPN, në punën e tij, nga muaji janar të vitit 2015, është përballur dy herë me raste të hakmarrjes. Herën e parë kur ndodhi replika ishte rast i mbyllur në lidhje me Shtëpinë e Fëmijës "Cseppko" në Budapest në vitin 2016. Së dyti, MPN përjetoi një shembull të hakmarrjes të rastit të një vizite në Qendrën për Ndihmë të Personave të Moshuar "Visegrad" në vitin 2018.

Në kapitujt e tjerë, do të dëshironim t'i përmbledhim edhe konkluzionet për metodat e ndryshme të veprimit me dy shembuj të ndryshëm të hakmarrjes.

Padi për të drejtën civile kundër MPN pas publikimit të raportit

MPN realizoi vizitë në Shtëpinë e Fëmijës "Cseppko" në Budapest në vitin 2016. Pas publikimit të raportit për vizitën në ueb-faqen e MPN, Shtëpia e Fëmijës "Cseppko" ngriti padi civile kundër zyrës së Komisionerit për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëposhtëm "Zyra"), duke e theksuar cenimin e të drejtave të personit të tij mbi bazë të pjesës 2:42 të Kodit Civil të Hungarisë dhe kërkonte dëmshpërblim. Paditësi pohonte se raporti përfshin akuza të rreme për prostitucion të fëmijëve dhe përdorim të drogave/ilaceve sa i përket institucionit. Me qëllim të sigurimit të provave, paditësi kërkoi nga Gjykata ta angazhoj MPN ti paraqes të gjitha dokumentet bazë të raportit. Duhet të theksohet se procedura e këtillë do ta rrezikonte konfidencialitetin e informatave të cilat i pranon MPN-ja dhe mbrojtjen e personit nga i cili MPN i pranon këto informata gjatë kohës së hetimeve. Fillimisht, gjykata e hodhi poshtë kërkesën



dhe deklaroi se raporti nuk përmban kurrfarë faktesh të cilët do ti cenonin të drejtat e paditësit. Prandaj, Gjykata nuk e mundësoi kërkesën në lidhje me paraqitjen e dokumenteve mbi bazë të të cilave ishte publikuar raporti, meqë një gjë e këtillë ishte irelevante. Gjithashtu, Gjykata deklaroi se nëse deklaratat për raportin nuk kanë qenë të favorshme për paditësin, ky fakt nuk dha arsye që të hapet procedurë gjyqësore me qëllim që të zbatohet raporti i cili është më i favorshëm. Kjo do të thotë ankesë kundër raportit të MPN, gjë që nuk është e lejueshme sipas Ligjit për Avokatin e Popullit.

Paditësi griti padi kundër aktakuzës, por gjithashtu edhe Zyra, si e paditur, paraqiti ankesë. Në ankesën e vet, i padituri ka kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të deklaroj se deklaratat e raportit fare nuk mund të jenë bazë për ngritjen e padisë për të drejtën civile. Gjykata i refuzoi të dyja ankesat. Në lidhje me ankesën e të akuzuarit, Gjykata deklaroi se Zyra mund të paditet në kuadër të procedurës për të drejtën civile në bazë të cenimit të të drejtave të personit, kjo mundësi nuk u përjashtua për faktin se nuk ka ankesë kundër përmbajtjes së raportit të hartuar nga MPN. Të drejtat e personit, të mbrojtura me Kodin Civil mund të zbatohen kundër kujtdo. Raporti nuk përmban deklarata për prostitucion të fëmijëve ose përdorim të drogës/ilaceve, megjithatë vihet në dukje se ka shenja të fenomeneve të këtilla të cilat janë të identifikueshme në institucion.

Meqë aktgjykimi përfundimtar ka të bëjë me mundësinë teorike të udhëheqjes së padisë civile kundër MPN, nëse raporti i tij përmban deklarata të rreme me të cilat cenohen të drejtat e personit, është e domosdoshme që me kujdes të madh MPN t'i analizoj pretendimet dhe deklaratat e fakteve të cilat duhet të përfshihen në raportet e tij.


Reprezalja e ushtruar në Qendrën për Ndihmë të Personave të Moshuar "Vishegrad" në lidhje me vizitën e OPKAT para publikimit të raportit

Deklarata e fakteve

Zyra e Komisionerit për të Drejtat Themelore si MPN e Hungarisë zhvilloi vizitë në Qendrën për Ndihmë të Personave të Moshuar në "Vishegrad", i drejtuar nga Fondacioni "Vishegrad Aranukor" më datë 11 dhjetor të vitit 2018. Pas vizitës, Zyra e Komisionerit për të Drejtat Themelore pranoi ankesë të paraqitur nga një i afërm e të përkuajdesurit në Qendër në të cilën përshkruhet se marrëveshja për përkuajdesjen e gruas së moshuar e cila jeton në këtë Shtëpi për persona të moshuar është ndërprerë nga ana e institucionit, me arsyetimin e bazuar mbi faktin se ajo ka paraqitur akuza deri te MPN të cilat kanë qenë të rreme dhe të pafavorshme për Shtëpinë. Ankesa është paraqitur në datën para se MPN ta publikoj raportin për vizitë, përkatësisht faktet e pranuar gjatë kohës së vizitës me të përkuajdesurit të Qendrës nuk janë vlerësuar si duhet. Letra për ndërprerjen e qëndrimit i është bashkangjitur ankesës, përfshirë edhe njoftimin se e përkuajdesura e Qendrës do ta braktis Shtëpinë pas skadimit të afatit prej 3 muajsh.

Kompetencat e MPN

MPN me mandat preventiv nuk merret me ankesa individuale. Ankesat individuale analizohen në kuadër të aktiviteteve të Komisionerit për të Drejta Themelore. Edhe krahas kësaj, rregulli i përgjithshëm i aplikuar në Hungari, rasti i përshkruar më lartë u dërgua në kompetencë të MPN. Shkaku është se e sipas nenit 21, pjesa (1) e Protokollit Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera Brutale, Jonjerezore, Përcmuese ose Ndëshkuese, të publikuar në Hungari me aktin CXLI të vitit 2011, *asnjë organ ose person zyrtar nuk guxon të urdhërojë, zbatojë, lejojë ose tolerojë çfarëdo qoftë sanksioni kundër cilitdo person ose organizatë për shkak se ka raportuar tek Mekanizmi Parandalues Nacional çfarëdo qoftë informata, pavarësisht se a kanë qenë të vërteta ose jo, dhe ndaj asnjë personi tjetër ose organizate nuk duhet të*



ketë paragjykimë në çfarëdo qoftë mënyre. Gjithashtu, në pikën 4 të parimeve të përgjithshme të Politikës së Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës dhe Llojeve tjera Brutale, Johumane, Përcmuese ose Ndëshkuese me hakmarrje lidhur me mandatin për vizita, (...) Shtetet duhet të sigurohen se të gjitha aktet e pretenduara të hakmarrjes dhe frikësimit hulumtohen në kohë, në mënyrë të paanshme dhe efikase, se përgjegjësit nxirren para drejtësisë dhe se viktimave u sigurohen mjete përkatëse.

Sa i përket legjislacionit hungarez, neni 39 / E i Ligjit CXI nga viti 2011 për Komisionerin për të Drejta Themelore (në tekstin e mëposhtëm "Akti i Avokatit të Popullit") deklaroi se *askush nuk mund të vuaj kurrfarë dëmi për shkak të faktit se ai/ajo ka raportuar çfarëdo qoftë informatash deri te Komisioneri për të Drejta Themelore dhe deri te anëtarët e autorizuar të Mekanizmit Parandalues Nacional.*

Në bazë të rregullativës së theksuar, MPN e ka për detyrë të zbatoj mjete efikase për çdo rast të hakmarrjes, me ç'rast konfirmohet kompetenca e MPN për ankesat individuale të cilat kanë të bëjnë me hakmarrjet e këtilla.

Masat e MPN

MPN miratoi masa të drejtpërdrejta në mënyrë që të siguroj mjete efektive për hakmarrje, siç është theksuar në pikën 2.1. Janë zbatuar masa në tre nivele, me bashkëpunim të plotë, të shpejtë dhe efektiv të organeve tjera, përkatësisht Zyra e Qeverisë dhe Prokurori Publik:

- a) dëmshpërblim nga ana e Fondacionit si faktor i institutit
 - b) kërkesë pranë Zyrës së Qeverisë që të ketë kompetencë për supervizion
 - c) kërkesë deri te Prokurori Publik që ta hetoj rastin
-
- a) Anulimi i marrëveshjes për kujdesin e të përkujdesurit në Qendër, si hakmarrje e ndër-marrë për ankesën deri te anëtarët e MPN gjatë vizitës në Qendrën për Ndihmë të Personave të Moshuar "Vishegrad", u shpall nga ana e Fondacionit "Vishegrad Aranukor" si menaxher privat i institucionit. Me qëllim të kompensimit të drejtpërdrejtë të dëmit, Komisioneri për të Drejtat Themelore si MPN, duke u thirrur në nenin 2, pjesa (1) e OPKAT dhe nenin 39 / E të Ligjit për Avokatin e Popullit, e tërhoqi vëmendjen e Bordit Këshillëdhënës të Fondacionit për faktin se anulimi është i paligjshëm. Edhe pse institucioni nuk guxon të zbatoj kurrfarë hakmarrje, madje edhe në rast të informatave të pranura të rreme nga i përkujdesuri i Qendrës, MPN vuri në pah se në rastin konkret, MPN akoma nuk e hetuar rastin për të cilin bëhet fjalë. MPN-ja kërkoi nga Bordi Këshillëdhënës i Fondacionit, si subjekt i interesuar, menjëherë ta tërheq ndërprerjen e marrëveshjes për kujdes dhe ta njoftoj MPN për masën e tij në afat prej 30 ditësh nga pranimi i letrës tek MPN. Në përgjigje, kryesuesi i Bordit Këshillëdhënës e njoftoi MPN se anulimi është tërhequr.
 - b) Me kërkesë të MPN, Zyra e Qeverisë i hulumtoi rrethanat e ndërprerjes pas këqyrjes në vend ngjarje. Ai deklaroi se ndërprerja nuk është e bazuar dhe nuk është në përputhje me ligjin në fuqi. Fakti se ankesa e të përkujdesurit të Qendrës, drejtuar deri te MPN ishte shkak për ndërprerjen e Marrëveshjes për kujdes, mund të shkaktojte frikë tek të përkujdesurit e tjerë të Qendrës dhe të jetë pengesë për shfrytëzimin e të drejtës për ankesë. Zyra qeveritare e vëmendjen e drejtoi tek instituti me atë që në të ardhmen t'i përmbush të gjitha kërkesat për punë të ligjshme.
 - c) Me kërkesë të MPN, Prokurori Publik, i cili e analizoi dokumentet lidhur me rastin, zbatoi këqyrje të jashtëzakonshme në vend të ngjarjes, përfshirë edhe intervistat me personat e prekur. Rezultati nga ky hulumtim është se për faktin se ndërprerja është tërhequr, nuk



ka pasur bazë për veprime të mëtutjeshme nga ana e prokurorit publik.

Mediat publike


Sa i përket faktit se ndërprerja e paligjshme, e cilësuar si e paligjshme, seriozisht e cenon të drejtën e ankesës, me çka rrezikohet funksionimi i kompensimit të dëmeve, MPN e njoftoi publikun për ndërprerjen e paligjshme përmes mediave të shkruara dhe sociale.

Konkluzion

MPN i Hungarisë u ballafaqua me problemin e hakmarrjes në dy nivele: në rastin e parë, çështja tanimë ishte mbyllur dhe MPN u detyrua ta mbroj pikëpamjen e tij para gjykatës në kuadër të padisë. Në rastin e dytë, MPN u detyrua të veproj menjëherë pas vizitës, para se të përgatitet dhe publikohet raporti për hulumtimin. Dy shembujt e ndryshëm të hakmarrjes kërkonin qëndrime dhe hapa të ndryshëm në emër të MPN.

Në rastin e parë, vetë MPN ishte i involvuar në padinë, ndërsa raportin e tij gjykata e analizoi lidhur me kërkesën e iniciuar nga institucioni i vizituar si paditës, përkatësisht nëse raporti përmban ose jo çfarëdo qoftë pretendimesh të cilët do t'i cenonin të drejtat e personit. Konkluzioni është se, ndonëse të burgosurit nuk mund të vuajnë kurrfarë dëmi për shkak të çfarëdo qoftë informacioni drejtuar MPN, raportin e MPN mund ta shqyrtojë gjykata lidhur me cenimin eventual të të drejtave të personit.

Në rastin e dytë, institucioni i vizituar gjatë intervistave të zhvilluara nga ata janë hakmarrje kundër të burgosurve të cilët kanë biseduar me anëtarët e MPN. Si pasojë e kësaj, MPN u detyrua të reagoje në mënyrë aktive me qëllim që ti mbroj këta persona. Në lloje të këtilla të rasteve, është e domosdoshme që MPN të veproj në kohë dhe në mënyrë efikase, me qëllim që të siguroj mbrojtje, në bashkëpunim me organet e tjera. Përpjekje tjetër mund të jetë MPN të zhvilloj një numër të madh të intervistave të cilat parandalojnë identifikimin e burimit të informatave dhe në këtë mënyrë të pengohet zbatimi i çfarëdo qoftë hakmarrjeje nga ana e institucionit i cili është nën hetim.



Aleksandar Trenkoski

Këshilltar për prevenim nga tortura, MPN Republika e Maqedonisë së Veriut

Të dashur miq dhe të respektuar kolegë,

Reprezalitë mbi personat dhe organizatat për shkak të kontaktit të realizuar dhe informatat e shpërndara me mekanizmat kombëtarë parandalues ose trupat tjerë monitorues, me të njëjtat ose me kompetenca të përafërta, seriuizisht mundet ti minoj përpjekjet tona në luftë kundër torturës në vendet ku privohet liria.

Prej kësaj del edhe obligimi ynë që të zhvillojmë politika përkatëse për zvogëlimin e rreziqut nga lloji i tillë i reprezavive.

Pas vizitës së shtetit tonë në vitin 2017, Nënkomiteti për Parandalim nga Tortura, në raportin e adresuar deri te ne si Mekanizëm Kombëtarë Parandalues, na drejton rekomandime për nevojën e miratimit të udhëzimeve për mbrojtjen e personave të privuar nga liria bga reprezalitë.

Duke e pasur parasysh konstruktivitetin e rekomandimit të tillë, ne si MKP u angazhuam drejt përmirësimit të sistemit metodologjik gjatë të vepruarit, duke implementu masa dhe aktivitete plotësuese në praktikë në drejtim të mbrojtjes të personave të cilët na japin informacione.

Në këtë drejtim, ne aktivizuam disa masa dhe aktivitete praktike të cilat i përdorim gjatë punës, e gjitha e bazuar në rekomandimet e parapara në doracakët e organizatave ndërkombëtare të cilat merren me parandalim nga shkeljet dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të ndalur.

Megjithatë, kjo qasje strategjike akoma nuk është futur në dokument oficial i cili do të paraqesi plotësim të akteve interne të sjellura gjatë parandalimit nga tortura.

Ndryshe, plotika jonë aktuale që zbatohet për parandalim dhe mbrojtje nga reprezalitë përbëhet prej tre elementeve, edhe ate:

1. Identifikimi i target grupës i ekspozuar në rrezik nga reprezalitë;



2. Ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve për zvogëlimin e rrezikut nga reprezalitë dhe
3. Mënyra e të vepruarit në raste kur pranojmë informata për frikësim ose reprezalitë.

Si **target grupa** të identifikuar dhe të ekspozuara në rrezik nga reprezalitë janë:

- Persona të privuar nga liria dhe persona zyrtarë me të cilët bisedojmë gjatë vizitave;
- Organizata të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe na japin informacione për gjendjen në vendet ku bëhet privimi nga liria dhe
- Familjarë, miq ose persona tjerë të cilët na sigurojnë informacione për trajtimin e personave të privuar nga liria;

Masa dhe aktivitete konkrete, të cilat i ndërmarrim për zvogëlimin e rrezikut nga reprezalitë eventuale, mundet të ndahen në:

- Aktivitete të cilat i ndërmarrim para vizitës;
- Masa dhe aktivitete që i ndërmarrim gjatë kohës së vizitës, si dhe
- Aktivitete që rrjedhin pas vizitave të kryera

Aktivitete të cilat i ndërmarrim para vizitës përbëhen nga grumbullimi i informacioneve për raste më të hershme ku ka pasur sanksionim të personave të cilët kanë kërkuar mbrojtje të të drejtave nga trupa të jashtëm, organe ose organizata.


Burimi kryesor i këtyre informatave janë mjetet për informim publik, raportet e organeve dhe organizatave që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe kontakti me ata persona të cilët kanë informacione për gjendjen dhe trajtimin në vendet ku bëhet privimi nga liria.

Masat dhe aktivitetet gjatë vizitave konsistohen nga:

1. Përkushtim i posaçëm i kujdesit ndaj karakterit konfidencial dhe mënyrës se si udhëhiqen bisedat me personat e privuar nga liria dhe personat zyrtarë. Respektivisht,
 - a. I kushtohet kujdesë zgjedhjes së vendeve ku bisedohet;
 - b. Bisedat me personat e privuar nga liria gjithnjë të bëhen pa prezencën e personave zyrtarë,
 - c. Sipas mundësive të bisedohet me sa më shumë persona
 - d. Ndërsa veçanërisht të i kushtohet vëmendje edhe përmbajtjes së bisedave, në varësi nga ajo se a bëhet fjalë për biseda individuale apo grupe;
2. Gjithashtu gjatë vizitave shqyrtohet edhe mundësia e personave të privuar nga liria për qasje tek mekanizmi për ankesa, ndërsa në mënyrë të obligueshme personave zyrtarë i'u sugjerohet edhe për ndalesën e represaljeve të paraparë me nenin 21 të Protokollit fakultativë.

Masat dhe aktivitetet që vijnë pas vizitave të realizuara kryesisht konsistohen nga:

- Përkushtim të kujdesit mbi përmbajtjen e raportit që të mos zbulohet burimi i informacioneve, si dhe të mos publikohen të dhëna personale për personat me të cilët është biseduar pa aprovimin e tyre;
- Gjithashtu, në varshmëri të gjendjeve të konstatuara bëhet vlerësim i rrezikut nga represaljet e mundshme, në bazë të asaj se çka bëhet dhe plan për nevojën e ad-



hoc vizitës vijuese.

Udhëzimet për veprim pas pohimeve të marra për represalje, gjegjësisht e pasqyrojnë qëndrimin e tanishëm të ekipit të MPN sipas kësaj çështje, e ajo është se:

- Ekipi i MPN nuk realizon hetime individuale për shkelje eventuale të të drejtave të personave të privuar nga liria, ndërsa pohimet për çfardo llojë presioni dhe represalje ndaj ndonjë personi, pas pajtueshmërisë nga ai person, i procesuonë tek autoritetet kompetente të cilat duhet të ekzaminonë se vallë me të vërtetë ekzistonë shkelje e të drejtave të personit.
- Ekipi i MPN e përcjellë rezultatin e procedurave dhe në varshmëri nga ajo i planifikon aktivitetet vijuese.

Shkurtimisht kjo është qasja ynë strategjike aktuale për parandalim dhe mbrojtje nga represaljet, ndërsa përndryshe **në praktikë** nuk kemi pasur rast që ndokush të ankohet për represalje për shkak të informacioneve që i ka shpërndarë me ne.

Megjithatë, kemi pasur një rast kur më shumë organizata janë ballafaquar me vështirësi gjatë realizimit të aktiviteteve të tyre, gjoja për shkak të dorëzimit të informacioneve tek ne si MPN.

Në këtë kuptim, gjatë vitit 2016 më shumë organizatave i'u është kufizuar qasja në qendrën e përkohshme tranzitore Tabanoc në orët e mbrëmjes kur në të vërtetë janë kryer deportime kolektive të migrantëve dhe refugjatëve përtej kufirit të vendit tonë. Pas rekomandimeve të drejtuara tek autoritetet kompetente, organizatave joqeveritare i'u është mundësuar qasje e papenguar 24 orëshe, me çka në tërësi është implementuar rekomandimi i drejtuar.

Në fund të këtij prezantimi do dëshiroja që të theksojë se pritshmëritë nga ky takim janë që i njëjti të kontribuojë drejtë përmirësimit të mëtutjeshëm të qasjes tonë metodologjike në parandalimin dhe mbrojtjen nga represaljet.

Ju faleminderit për vëmendjen Tuaj!



Zdenka Perovic

Zëvendëse e Avokatit të Popullit të Malit të Zi për MPN-në

Në Ligjin për Avokatin e popullit të Malit të Zi, neni 25 c, paragrafi 3 thotë: “Askush nuk mundet të jet i sanksionuar dhe as të vuajë pasoja për shkak të veprimit në pajtueshmëri me nenin 2...”, i cili thotë: “Eprori, përkatësisht personi i cili udhëheq me organin, institucionin dhe organizatën është i detyruar Avokatit të popullit ... t’i mundësojë vizitë të papenguar dhe kontroll të hapësirave në të cilat gjenden ose do të mundeshin të gjenden persona të privuar, si dhe bisedë me personat e privuar nga liria dhe me persona të tjerë të cilët mund të japin informata relevante në lidhje me dyshimin se shkelen të drejtat e njeriut pa prezencën e personit zyrtar; dhe t’i vënë në dispozicion të gjitha të dhënat dhe të mundësojnë inspektim të drejtpërdrejtë në dosjet zyrtare dhe dokumentet që i përmbajnë ato të dhëna”.


Avokati/katja, zëvendës avokati/katja, këshilltari/tarja kryesor/e e Avokatit/kates të popullit dhe këshilltari/tarja e Avokatit/kates të popullit nuk mund të thiren për përgjegjësi për mendimin ose rekomandimin të cilin e kanë dhënë gjatë ushtrimit të funksionit, përkatësisht për veprimet konform kompetencave dhe autorizimeve të përcaktuara me këtë ligj gjatë rrjedhës së mandatit të tyre, përkatësisht gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës.

Në Ligjin për të dhëna të besueshme të Malit të Zi, neni 26 thotë:

Qasje pranë të dhënave të besueshme pa leje për qasje pranë të dhënave të besueshme ka: në mes të të lartëpërmendurve edhe Avokati i popullit i Malit të Zi, dhe atë vetëm pranë të dhënave të besueshme të nevojshme për kryerjen e autorizimeve të tij, në pajtueshmëri me ligjin.

Gjithashtu është theksuar se me arrdhjen në detyrë, nënshkruhet deklarata se me të dhënat e besueshme do të veprohet konform ligjit dhe rregulloreve të tjera relevante.

Nocioni “hakmarje” shpesh herë përdoret për tu përshkruar praktika e ndëshkimit të personave në paraburgim të cilët kanë biseduar, bashkëpunuar, i kanë dhënë informata MPN-së ose vëzhguesve të tjerë të pavarur, nga ana e rojtarëve, zyrtarëve policorë ose të burgut.



Mirëpo, "hakmarja" e cila definohej si akt i shpagimit, nuk është precize, për shkak se pasojat të cilat i durojnë individët të cilët janë të ekspozuar ndaj abuzimit nuk rezultojnë me të vërtetë nga kryerja e ndonjë "kundërvajtjes" e cila gjoja se e arsyeton hakmarjen ose ndëshkimin përkatësisht sanksionin që ka pasuar. Sanksionet mund të jenë në formë të ndryshme, përveç personave në paraburgim, mund t'i vuajnë edhe persona të tretë, anëtarë të familjeve, gjithashtu edhe persona zyrtarë. APT - preferon të përdorë termin më adekuat, "sanksion", që njëkohësisht është edhe term i përdorur në nenet 15 dhe 21 të OPKAT-it duke përshkruar secilin dënim që është rezultat i vetë kontaktit me vëzhguesit e pavarur. Ndërkaq siç është theksuar mund të shikoni se ligji i Malit të Zi për Avokatin e popullit e përmban këtë term më të zgjerruar.

Sistemi i përgjithshëm për parandalimin e torturës fillon nga vizita e pavarur mbikëqyrëse në vendet e paraburgimit dhe nga kontakti i drejtpërdrejtë ndërmjet vëzhguesve dhe personave të privuar nga liria. Prandaj është tejet brengosës fakti që persona të caktuar të paraburgosur, të cilët përndryshe gjenden në një situatë vulnerabile, kanë qenë të ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe abuzimeve, si rezultat i kontaktit të tyre me institucionet të cilat janë themeluar për të parandaluar maltretimin. Këto akte nuk paraqesin vetëm shkeljen e të drejtave të njeriut por edhe kërcënim ndaj vetë minisonit të të gjitha organeve mbikëqyrëse në përgjithësi. Pa marrë parasysh formën e hakmarrjes, ajo nuk guxon të tolerohet, ndërsa kryesisht duhet menjëherë të sanksionohen në mënyrë përkatëse.

Kjo është një nga çështjet e cila na nxit për bashkëpunim dhe këmbim të informative për rastet e evidentuara, të cilat do të kontribuonin drejt dukshmërisë më të madhe të problemit, dhe e gjithë kjo me qëllim të përfundimit të sistemit global për parandalim. Të dhënat dhe analizat na mundësojnë ta shohim shtrirjen e modaliteteve të këtij fenomeni dhe rrethanat konkrete në të cilat këto kanë ndodhur, që mund të kontribuojë drejt zhvillimit të modaliteteve të veprimit parandalues të përshtatshme për çdo situatë dhe rrethanë që veç më ka qenë lëndë e analizës.

Aktet e hakmarrjes fillimisht janë të gjeneruara nga kushtet në ambientin konkret që u mundëson të ndodhin. Deri sa institucionet shtetërore janë të obliguara ta ndalojnë hakmarjen, trupat mbikëqyrës kanë përgjegjësi të veçantë për zbutjen e rrezikut.

Për realizimin e parimit të promovuar "mos shkakto dëm" me rëndësi primare është përgatitja themelore e vizitave. Në praktikë u kristalizuan mënyrat më efektive për zgjidhjen e problemit me hakmarrjen:

- Me ndarjen e kohës së mjaftueshme që do të shfrytëzohet në çdo vend të vizituar,
- Të sigurohet se intervistat do të zhvillohen në konfidencialitet të plotë dhe
- Zhvillimi i bisedave të bëhet me sa më shumë persona, me çka do të mundësohet mosnjohja e pjesërishme ose e plotë e personave të cilët kanë dhënë informacion të caktuar i cili më vonë do të ishte shkas për bisedë me udhëheqësinë ose rekomandim eventual.

Nga ana tjetër mendohet për amandamente ligjore për kriminalizimin e hakmarrjes, si mënyrë e luftës kundër mosndëshkimit dhe mesazh i fortë drejt kryesve potencial.

Sipas metodologjisë tonë, gjatë rrjedhës së vizitës në bisedën hyrëse me udhëheqësinë, MPN-ja paralajmëron me domosdoshmëri se të gjitha bisedat që do të zhvillohen me personat e privuar nga liria dhe zyrtarët janë të besueshme dhe se askush nuk guxon të duron çfarë do formë të frikësimit, gjatë rrjedhës dhe pas përfundimit të vizitës, për shkak të bisedave të mundëshme me përfaqësuesit e MPN-së, ndërkaq veçanërisht hakmarje ose ndonjë lloj të sanksionit pas përfundimit të bisedës dhe informatave të dhëna dhe në përgjithësi pas bashkëpunimit me MPN-në.

Dhe në fund të vizitës, gjatë përfundimit të bisedës, njëra nga temat është edhe frikësimi dhe hakmarja dhe paralajmërimi se MPN-ja në interval të caktuar kohorë sërisht do ta



vizitojë institucionin saktësisht se do të realizojë follow up vizitë dhe sërisht do të bisedojë me bashkëbiseduesit dhe personat e tjerë të cilët do të mundeshin t'i japin informacione për situatën në institucion, pas vizitës paraprake të MPN-së.

Veprimi i MPN-së në raste individuale të hakmarjes dhe frikësimit

Në punën tonë të deritanishme kishim dy raste karakteristike në të cilat u morëm me këtë fenomen. Njëri ishte drastik dhe i përcjellur nga mediat nën emrin e njohur të ashtuquajtur "Ngjarja e Janarit" e vitit 2015 e cila ndodhi në Byronë për ekzekutimin e sanksioneve penale – Podgoricë.

Kronologjia e ngjarjes:

Institucioni u njoftua përmes linjës telefonike nga një i burgosur deri te një këshilltarë i institucionit tonë në orët e pasdites. Thirrja ndodhi gjatë aksionit, kështu që këshilltari jonë dëgjoj tinguj dhe zëra autentik, ulurima pas të cilave arriti të konkludojë se atje me të vërtetë diçka e tmershme po ndodhë. Përleshja ndodhi ndërmjet personave të burgosur dhe nëpunësve të sigurimit (në poligon në hapësirë të hapur, seksioni i mbyllur i Entit ndëshkues – korrektues);

Përfaqësuesit e institucionit (MPN) menjëherë pas njoftimit për incidentin (po të njejtën ditë) nisen për në Byronë për ekzekutimin e sanksioneve penale. Hapat e mëtutjeshëm ishin veprimet reaktive të institucionit d.m.th. zyrtarëve për mbrojtje nga tortura- U realizua bisedë me Drejtorinë e Byrosë për ekzekutimin e sanksioneve penale;

U realizua bisedë me personat e dënuar pjesëmarrës në përleshje, të zhvendosur në repartin disiplinorë dhe personat e dënuar të zhvendosur në Burgun – Bjello Polje;


U realizua bisedë me nëpunësit e sigurimit;

U hapë procedura me vet iniciativë;

Me rastin e incidentit në Byronë për ekzekutimin e sanksioneve penale me datën 14 dhe 15 Janar të këtij viti, Avokati i popullit i Malit të Zi me vet iniciativë formoj lëndë dhe hapi procedurë hetuese. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve, rrethanave dhe deklaratave të dëshmitarëve, në Mendimin përfundimtarë është konkluduar se në ditët kritike në byronë kanë ndodhur dy ngjarje të ndryshme sipas hapësirës edhe kohës - e para në terrenin sportiv të ENK-së rreth orës 14 e 30 dhe e dyta pas orës 17 në Seksionin disiplinorë dhe ditën e ardhëshme gjithashtu në vendet e tjera të byrosë. Është konkluduar se në rastin e terrenit sportiv të ENK – së në Spuzh rreth orës 14 e 30, nuk ka ardhur deri te përdorimi i forcës së tepëruar nga ana e personave zyrtarë dhe shkleja e të drejtave të personave të dënuar.

Mirëpo në rastin e seksionit disiplinorë po të njejtën ditë në datën 14 janar pas orës 17 pas shkuarjes së përfaqësuesit të Avokatit të popullit edhe të nesërmen me datën 15 Janar, personat zyrtarë me pa arsye kanë përdorur forcë dhe mjete për detyrim kundër 13 personave të dënuar, kanë keqtrajtuar, i kanë trajtuar në mënyrë jonjerëzore dhe nënçmuese dhe në atë mënyrë i kanë shkelur të drejtat e tyre të njeriut. Duke marrë parasysh intesitetin e forcës së përdorur dhe seriozitetin e pasojave - lëndimeve trupore të tre personave të dënuar, është vlerësuar se në rastin e tyre trajtimi jo njerëzorë dhe degradues, sipas karakteristikave të veta paraqet torturë.

Pas incidentit në poligon, të gjithë të burgosurit- pjesëmarrës në incidentin janë zhvendosur në seksionin disiplinorë dhe vendosur në hapsirën për shetitje, ku përfaqësuesit e Avokatit të popullit biseduan me të gjithë të burgosurit. Pas shkuarjes së tyre, dyert e pjesës për shetitje hapen, duart u lidhen me pranga dhe zyrtarët e Byrosë (të maskuar) fillojnë ti rrahin; (po të njejtën ditë dhe të nesërmen në orët e pasdites) me ngacmime për shkak të thirjes së Avokatit të popullit me çka qartë u është bërë me dije se ky është njëri nga motivet për ndëshkimin e tyre. Për sjelljen e këtij konkluzioni kontribuan edhe deklaratat të cilat personat e dënuar i dhanë në Prokurorinë themelore publike dhe gjetjet e ekspertëve medicinal.



Personat e dënuar veç më janë të dënuar në mënyrë disiplinore dhe penale, ndërsa procedura kundër zyrtarëve edhe pas më shumë se katër viteve, nuk është përfunduar as në shkallë të parë. Muajin e kaluar në një ngjarje publike në Podgoricë, gjykatës i Gjykatës së apelit e cila kryente kontrollin e kësaj procedure deklaroi se procedura është udhëhequr pa gabim dhe se nuk ka pasur kurrfarë vërejtje. Mirëpo, përfaqësuesja e një organizate joqeveritare, e cila vëzhgon këtë procedurë, tregoi se seanca është anuluar dy herë për arsye se zyrtarët kanë qenë në ndonjë garë sportive.

Këtu do të isha kthyer në momentin kur ju thash se të burgosurit i thirren përfaqësuesit tanë për ndihmë, për shkak se dëgjuan ulurima dhe rrahje të të burgosurve të tjerë në korridor. Do të kisha dhënë një temë për diskutim, çka mendoni për këtë. A keni pasur ndonjë rast të ngjajshëm? Si do të vepronit në situatë të tillë? A ka qenë përgjigjja e përfaqësuesve tanë ndaj kësaj thirrjeje për ndihmë në suaza të parandalimit ose të mbrojtjes.

Rasti i dytë në vitin 2019

Gjatë kohës së vizitës së rregullt të institucionit për mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve të Malit të Zi të muajit shkurt të këtij viti, i cili meret me mbrojtjen institucionale të fëmijëve të pa mbrojtur me sjellje problematike, MPN-ja nga njëri prej shfrytëzuesve të mbrojtjes nga ky institucion u njoftua se është dënuar fizikisht nga ana e një punonjësi, ku kohë më parë kanë qenë në pushim kolektiv në pushimoren e fëmijëve në "Ivanovite Korita", deri sa një i punësuar tjetër ka qenë prezent dhe nuk ka intervenuar. Një shfrytëzues tjetër i vertetoi këto pohime në një bisedë të veçantë. Në ndërkohë, nëna e shfrytëzuesit të mbrojtjes paraqiti padi penale pranë prokurorisë kompetente.

Udhëheqësia e këtij institucioni është njoftuar me pohimet të cilat i pranoj MPN-ja dhe janë të paralajmëruar se duhet të ndërrmeren të gjitha masat e domosdoshme me qëllim të përcaktimit të përgjegjësisë së mundshme disiplinore të punonjësit dhe parandalimi i sanksionimit të mundshëm të shfrytëzuesit të mbrojtjes për shkak të informatës së dhënë pran ekipit të MPN-së. Janë kërkuar informata për masat e ndërmara dhe kemi marrë përgjigje se është realizuar procedura disiplinore në të cilën nuk është vërtetuar përgjegjësia e punonjësit dhe se drejtoresha ka miratuar vendim për zhvendosjen e dy punonjësve në detyra gjatë së cilave nuk do të kenë kontakt me këtë person të mitur.


Pas një kohe udhëheqësia na dërgoi një deklaratë me shkrim nga shfrytëzuesi në të cilën ai tërheq të gjithë atë që paraprakisht kishte deklaruar në llogari të punonjësit. Ekipi i MPN-së realizoi edhe vizitë kontrolluese, i brengosur se kjo deklaratë e shkruar është dhënë ndoshta nën detyrim dhe me qëllim të inspektimit të situatës në tërësi pas të gjitha ngjarjeve. Në këtë rast drejtoresha theksoi se kanë problem me shfrytëzuesit e mëdhenj dhe të fortë, të cilët tërë ngjarjen pas vizitës së ekipit të MPN-së e shfrytëzojnë për friksim të nëpunësve se nuk guxojnë të intervenojnë kur shfrytëzuesit bëjnë rëmuje dhe nuk respektojnë disiplinën dhe rendin e shtëpisë. Kjo sigurisht se ka ndikim, kështu që nëpunësit edhe gjatë incidenteve (agresionit ndërmjet personave të mitur, agresioni ndaj nëpunësve) përmbahen të reagojnë, që të mos jenë të akuzuar për veprime joadekuate dhe me këtë të rrezikojnë vendin e punës. Përndryshe, atmosfera e përgjithshme në këtë institucion është pozitive dhe është i dukshëm përkushtimi dhe përpjekjet e udhëheqësisë për zbatimin e të gjitha standardeve ndërkombëtare të cilat vlejnë për këto institucione. Ekipi i MPN-së vlerësoi se nuk duhet të realizojë bisedë me shfrytëzuesin që paraqiti ndëshkimin, pikërisht për arsye që të mos kontribuojë drejt nxitjes së sjelljes agresive të shfrytëzuesve ndaj nëpunësve, për arsye se lajmi për prezencën dhe interesin e tyre menjëherë zgjërohet në mesin e shfrytëzuesve.

Mirëpo, edhe në këtë vend ju kisha dhënë temë për diskutim - Si e shikoni në këtë rast parimin "mos shkakto dëm". Si do ta komentoni tërheqjen e nëpunësve pas rastit të përshkruar? A është sjellur në pyetje për shkak të kësaj, siguria e shfrytëzuesve dhe punonjësve?

Veprimi i MPN-së së Malit të Zi nuk ndërhyr në hetimin e mëtutjeshëm të rasteve të



veçanta të hakmarjes, por kjo kompetencë kalon në pjesën e shërbimit që merret me mbrojtjen nga tortura. Sigurisht se MPN-ja përmes shënimeve përfundimtare, qëndrimeve, raporteve përpiket të ndërrmeren masa të domosdoshme për mbrojtjen e individëve ose grupeve nga frikësimi dhe hakmarja.



Ivan Shelih

**Zëvendës Avokat i Popullit
dhe Shef i MPN-së së Sllo-
venisë**

Sipas ligjit, Ratifikimi i Protokollit Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Veprimeve tjera Brutale, Johumane, Përcmuese ose Ndëshkuese ("Gazeta Zyrtare" – Marrëveshja Ndërkombëtare, nr. 20/2006), teksti i Protokollit Fakultativ u bë pjesë e të drejtës vendore sllovene. Neni 8 i Kushtetutës parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe publikuara do të zbatohen drejtpërdrejt.

Në Slloveni, Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) mund të zbatohet drejtpërdrejt në nenin 21 të Protokollit Fakultativ, sipas të cilit asnjë organ kompetent ose person zyrtar nuk guxon të urdhëroj, zbatoj, lejojë ose toleroj ndëshkim kundër cilitdo person ose organizatë për raportimin e çfarëdo qoftë informacioni, pavarësisht nëse ato janë të vërteta ose jo, tek mekanizmi parandalues nacional, si dhe asnjë person e këtillë ose organizatë nuk duhet të jetë viktimë e paragjytimeve në çfarëdo qoftë mënyre.

Tani për tani, MPN-ja sllovene nuk përmban regullativa ose politika të posaçme në lidhje me hakmarrjen; në vend të kësaj, ajo e zbaton politikën e SPT në këtë fushë (dokumenti SPT nga muaji maj i vitit 2016: Politika e Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës dhe Veprimeve tjera Brutale, Johumane, Përcmuese ose Ndëshkuese për represalie në lidhje me mandatin e tij për vizita).

Prandaj, puna e MPN e ndjek parimin "E MOS DËMTIMIT" derisa të përgatitet për vizitë, gjatë kohës së vizitës dhe, kuptohet, gjatë kohës së procesit të raportimit. Besojmë se është tejet me rëndësi t'i përmbahemi parimit të konfidencialitetit dhe masave të cilat e parandalojnë identifikimin e personave të cilët paraqesin informata konkrete për MPN (përveç nëse vet personat nuk bien dakord me identifikimin). Më duhet të theksoj se isha anëtar i ekipit të MPN-së që ka vizituar njërin nga burgjet, i ftuar kohë më parë të dëshmoj për veprë penale (që nënkuptonte diskutim për akuza nga ligji i punës). Unë iu përgjigja ftesës së gjykatës dhe, gjatë kohës së dëshmimit tim, iu referova vetëm informatave dhe të dhënave të publikuara në raportin për vizitën e këtij institucioni. Në procedurën e mëtutjeshme, theksin e vura në nenin 21 (2) të Protokollit Fakultativ (*Informatat konfidenciale të mbledhura nga Mekanizmi Paran-*



dalues Nacional janë të privileguara. Të dhënat personale nuk publikohen pa pëlqimin eksplisit të personit të prekur).


Në praktikë, nuk pranojmë shpesh ankesa në lidhje me hakmarrjen. Kuptohet, në rast të akuzave të këtij lloji, reaguam menjëherë dhe e tërheqim vëmendjen e udhëheqësisë së institucionit për faktin se kjo praktikë nuk është e lejueshme. Nëse akuzat janë serioze dhe kërkojnë hetim më të thellë, rasti mund të shqyrtohet në bazë individuale, përkatësisht në kontekst të autorizimeve të cilat i kemi si Avokat i Popullit. Prandaj, besojmë se qëllimi i MPN filimisht është parandalues, përkatësisht ta ndërpres hakmarrjen. Nëse ka kushte për analizimin e të dhënave të këtij lloji, është e qartë se hakmarrja tanimë ka ndodhur. Prandaj, mekanizmat të cilët i posedon Avokati i Popullit për shqyrtimin e parregullsive të pretenduara, në këto raste, janë të dobishme.

Masat e tjera të cilat i kemi në dispozicion në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit për të drejtat e njeriut (raportimi tek autoriteti superior ose Qeveria, konferenca speciale për publikun, komunikata për media dhe, gjithashtu, për shembull, iniciativa për fillimin e procedurës disiplinore kundër nëpunësit publik, kallëzime penale, etj.), gjithashtu, mund të shfrytëzohen kur një gjë e këtillë është e nevojshme. Krahës kësaj, MPN-ja mund ta përsërisë vizitën e një institucioni ose të vendos të realizoj vizita më të shpeshta. Mekanizëm tjetër i rëndësishëm për parandalimin e hakmarrjes është mbajtja e kontakteve të përhershme me institucionet e sigurisë (për shembull, përmes numrave falas, me familjarët dhe avokatët të cilët janë në kontakt më të shpeshtë me të burgosurit).

Organizatat e përzgjedhura joqeveritare, gjithashtu janë pjesë e MPN-së në Slloveni. Kur kemi të bëjmë me akuza në lidhje me punën e nëpunësve policorë të cilët krijojnë aplikacione për mbrojtje ndërkombëtare, në vitin 2018 Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) vuri në pah parregullsi të dyshimta në punën e disa organizatave joqeveritare lidhur me sigurimin e informatave për shtetasit e huaj. Është raportuar se policia do të konsultohet me prokurorët shtetërorë në lidhje për fajësinë e mundshme të sjelljes së këtillë sipas Kodit Penal.

Meqë këto ishin akuza serioze, që kanë të bëjnë me sjelljen e organizatave joqeveritare, në fund të vitit 2018, e pyetëm MPB se a ka ndodhur konsultimi i paralajmëruar tanimë dhe prokurori kompetent shtetëror a ka marrë masa për zhvillimin e procedurës paraprake penale në lidhje me këtë (dhe, nëse është kështu, çfarë veprimesh kanë ndërmarrë). Përgjigjja që pranuar ishte se sipas mendimit të prokurorisë, sjellja e organizatave joqeveritare nuk është llogaritur si vepër penale. Ishte e qartë se vet policia nuk mund të konstatoj bazë për vepër penale, sepse zyra e prokurorit shtetëror vetëm ka paraqitur raport sipas nenit 148 (10) të Ligjit për procedurë penale (dhe jo, për shembull, kallëzim penal).

Në intervenimin e radhës të MPB, vërejtëm se, në mungesë të një baze më të fuqishme për akuza të këtilla serioze në lidhje me sjelljen e organizatave joqeveritare, presim që MPB-ja të jetë më e vëmendshme gjatë përhapjes së informatave të këtilla, sepse organizatat joqeveritare luajnë rol të rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Publikimi i përshpejtuar i informatave për publikun mund të jetë i dëmshëm për personat ose për organizatat e përfshira dhe mund të shkaktoj presion mbi punën e tyre, ta dëmtoj reputacionin, madje edhe të nxisë frikë. Nëse hetimi përfundon për këto pretendime dhe nëse dëshmohet se pohimet në lidhje me sjelljen e organizatave joqeveritare nuk konsiderohen si të pabazuara, gjithashtu, kërkuam të shtohet një njoftim në mënyrë që të shtohet në përgjigje, në të cilën theksohet nëse dhe si MPB-ja do t'i paraqes informatat relevante deri te publike, meqë pikërisht MPB-ja dyshonte në sjelljen e papranueshme të organizatave joqeveritare.



Jelena Samardzic

Këshilltare e pavarur e MPN-së Sërbi

Duke pasur parasysh se MPN-ja e Serbisë nuk ka dokumente formale si SPT sipas të cilave vepron, kur është në pyetje politika e hakmarjes ndaj individit për të cilin MPN-ja ka marrë informata, MPN-ja, parasëgjithash, përmes vizitave të tij parandaluese të vazhdueshme dhe prezencës së vazhdueshme në institucionet në të cilat gjenden personat e privuar nga liria, përpiqet t'i ri-kthejë organet shtetërore dhe personat zyrtarët nga çdo lloj i keqtrajtimit dhe ta orientojë vendin drejt krijimit të kushteve për jetesë në vendet ku janë vendosur personat e privuar nga liria në pajtueshmëri me standardet e pranuar në përgjithsi.

Gjithashtu, konform nenit 20 të Protokolit Fakulltativ ndaj Konventës kundër torturës, MPN-ja ka për detyrë të mbrojë identitetin e individëve të intervistuar, ndërsa në nenin 21 paragrafin 1 të Protokolit Fakulltativ është përcaktuar se “asnjë organ ose person zyrtarë nuk mund të urdhërojnë, zbatojnë, lejojnë ose tolerojnë çfarëdo sanksion kundër cilitdo personi ose organizate për shkak se mekanizmit parandalues nacional i kanë dërguar ndonjë informatë, qoftë e vërtetë ose e pavërtetë, dhe asnjë person i tillë ose organizatë nuk guxon të shkaktojë pasoja të tjera në çfarëdo mënyrë”. Duke u mbështetur në këto nene, ekipi i MPN-së gjatë vizitave vëmendje të veçantë u kushton mbrojtjes së identitetit të të gjithë personave të cilët kanë pasur kontakte me MPN-në dhe parandalimit të dukurive të hakmarjes. Në pajtueshmëri me këtë, MPN-ja aktivitetet e veta i bazon në përcaktimin e synimeve primare që duhet arritur gjatë kohës së vizitës parasëgjithash duke u udhëhequr në pajtueshmëri me parimet e konfidencialitetit dhe “do not harm” – mos shkakto dëm.


Para vizitës mbledhen informata nga sektori joqeveritar dhe nga burimet e tjera në suaza të Shërbimit profesional të Avokatit të popullit se, a ka pasur parashtresa nga institucione të caktuara dhe në lidhje me çka kanë qenë ato. Mëtej, hartohen pyetësor për intervista të individëve ose grupeve të personave të cilët gjatë rrjedhës së vizitës janë paraqitur për bisedë ose të cilët janë përzgjedhur rastësisht nga ana e ekipit të MPN-së. Gjatë rrjedhës së intervistës me personat, MPN – ja udhëhiqet konform parimit të konfidencialitetit, duke mbrojtur burimin e informacioneve, për çka individët informohen para fillimit të intervistës. Në këtë kuptim, gjatë rrjedhës së vizitës në vendet ku janë të vendosur personat e privuar nga liria, ekipi par-



asëgjithash i informon personat e privuar nga liria për mandatin e vet dhe i njofton se personat e interesuar mund të paraqiten për bisedë me ekipin e MPN-së në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe jo përmes personit zyrtar të institucionit. Duke vepruar në këtë mënyrë ngushtohet hapësira për friksime të mundshme të mëtutjeshme të individëve nga ana e punonjësve zyrtarë. Qasjen proaktive MPN-ja e thekson edhe në fillim të vizitës, në bisedën hyrëse me udhëheqësinë e institucionit, të cilës i bëhet me dije se ndërmarja e hakmarjes ndaj personave të cilët bashkëpunojnë me MPN-në paraqet shkeljen e dispozitave vendore dhe të përgjithshme të pranuara ndërkombëtare. Mirëpo, në qoftë se prapë egziston frika se identiteti i individit ose grupit do të zbulohet dhe në qoftë se paraqitet rreziku nga hakmarja pas përfundimit të vizitës, MPN-ja funksionin e tij parandalues do ta realizojë edhe përmes vizitave plotësuese “ad hoc” në këtë institucion ose seksion të caktuar, përmes bisedës me zyrtarët, sërish duke i përkujtuar për obligimet e pranuara të përgjithshme ndërkombëtare.

Mirëpo, në qoftëse pas përfundimit të vizitës nga individit ose grupi marim informata shtesë për frikësime ose hakmarje, ndërkaq me pëlqimin e mare nga individit ose grupi i prekur, në kuadër të Avokatit të popullit vepron Seksioni për veprime urgjente. Kuptohet se Seksioni për veprime urgjente, para se të shkojnë në institucionin çdo herë i kontakton përfaqësuesit e MPN-së, me qëllim që ti mbledh të gjitha informatat e nevojshme për rastin dhe institucionin konkret, por MPN-ja nuk mer pjesë në veprimet pas informatave shtesë, duke mare parasyshe faktin se bëhet fjalë për veprime ri-aktive.

Për njohuritë e fituara dhe pohimet për frikësime dhe hakmarje, MPN-ja mund të sugjerojë organeve kompetente përmes Raportit nga vizita duke përkujtuar se trajtimi i tillë është në kundërshtim me standardet e pranuara në përgjithësi, përmes lëshimit të komunikatës për publikun në të cilën shprehet brengosja për trajtimin e tillë, si dhe përmes njoftimit të trupave ndërkombëtare për dukurin e tillë në institucionin e caktuar ose sjelljet nga ana e punonjësve të caktuar në institucion. Politikën e hakmarjes ndaj personave të privuar nga liria, MPN-ja e realizon edhe përmes promovimit të vet në parandalimin e torturës, duke marë pjesë në konferenca, tryeza të rumbullakëta dhe punëtori, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për nevojën e sigurimit të mbrojtjes për kategoritë më vulnerable të personave.



Vedrana Pavloviq

Udhëheqëse e Sektorit të Avokatit të Popullit për të drejtat e Njeriut në Bosnjë dhe Hercegovinë


Në fillim, dua që t' i faleminderoj organizatorit që i ftuan përfaqësuesit e Bosnjës dhe Hercegovinës të marrin pjesë në takimin e rrjetit të MKP edhe këtë vit, sepse ne jemi i vetmi vend anëtare e rrjetit, i cili akoma nuk ka themeluar MKP. Për fat të keq, duhet tu informoj se në Bosnje dhe Hercegovinë, në vitin 2018, nuk janë kryer ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Avokatin e Popullit për të Drejtat e Njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë, me të cilat parashihet themelimi i Mekanizmit Parandalues në suaza të institucionit Avokat i Popullit, edhe pse ndryshimet e propozuara të ligjit janë pranuar nga Këshilli i Ministrave të Bosnjes dhe Hercegovinës.

Me rëndësi është të përsëritet se Bosnja dhe Hercegovina e ratifikoj Protokolin Fakultativ të Konventës kundër torturës dhe dënimit apo sjelljes brutale, jonjerëzore ose degraduese ose dënuese në vitin 2008 (OPKAT).

Si nënshkrues i Konventës së përmendur, Protokoli Fakultativ parashikon se të gjitha shtetet nënshkruese do të themelojnë mekanizëm që të parandalojnë torturë. Protokoli Fakultativ i Konventës kundër torturës dhe dënimit apo sjelljes brutale, jonjerëzore ose degraduese ose dënuese parashikon që të gjitha shtetet do të themelojnë mekanizëm për parandalim të torturës, të cilat nëpërmjet vizitave të rregullta të institucioneve në të cilat janë të privuar nga liria, janë të vendosura të veprojnë në mënyrë parandaluese me qëllim që përmirësohet trajtimi i tyre si dhe i kushteve në të cilat gjenden ata persona.

Edhe përkaj asaj për përmendëm, Avokatët e Popullit të Bosnjes dhe Hercegovinës ndër-morrën aktivitete konkrete me qëllim të përgatiten me kohë dhe të përgatiten për zbatimin e mandatit të këtij mekanizmi.

Për këtë shkak, në suaza të Projektit për ndërtim të kapaciteteve të Avokatit të Popullit për të Drejtat e Njeriut të Bosnjes dhe Hercegovinës, i cili ishte i realizuar në bashkëpunim me Avokatin e Popullit të Republikës së Bullgarisë dhe i përkrahur nga Ambasada e Bullgarisë në Bosnje dhe Hercegovinë, stërvitja e domosdoshme për personelin e Avokatit të Popullit ishte realizuar nga ana e ekspertëve bullgarë, për mandatin dhe funksionimin e Mekanizmit Parandalues dhe me atë u krijuan parakushte që institucioni Avokati i Popullit të ndërmarri rolin e këtij



mekanizmi. Ekipi përbëheshte nga tre ekspertë bulgarë për MKP, kurse stërvitja ishte e përbërë prej dy segmenteve, punë teorike dhe praktike. Dita e parë e stërvitjes ishte pjesa teorike e shkollimit nëpërmjet të cilës të punësuarit në institucionin tonë u njoftuan me mandatin e MKP të Republikës së Bullgarisë, metodologjinë e vizitave të tyre, funksioni i tyre, mënyra e njoftimit dhe niveli i implementimit të rekomandimeve. Dy ditët tjera të stërvitjes kyqën punë në terren, përkatësisht vizitë të Institucioneve ndëshkuese-përmirsuese „Banja Luka“, Klinikës Psikiatrike „Banja Luka“ dhe Drejtorisë Policore „Banja Luka“. Në syza të këtyre vizitave pjesëmarrësve në arsim dhe arsimtarëve, udhëheqja e këtyre institucioneve e prezentonte punën dhe organizimin e këtyre institucioneve dhe të njëjtët u përgjigjen në të gjitha pyetjet që u parashtruan.


Si pjesë e Projektit, Avokati i Popullit vizitoj administrata më të mëdha policore në Bosnje dhe Hercegovinë që të vërteton kushtet në hapsirat e paraburgosjes. Në këtë drejtim, ishte i përgatitur dhe i shpallur në opinion raport i veçantë për gjendjen në administratën policore në Bosnje dhe Hercegovinë. Vizita e vendeve ku persona, në mënyra të ndryshme, e kanë të kufizuar lirinë e lëvizjes, janë mjete efikase për parandalimin dhe luftimin e torturës. Në bazë të të dhënave të grumbulluara nëpërmjet intervistave me udhëheqjen e pushtetit policor, përkatësisht stacioneve policore të përfshira me Raportin, është përfundar se zyrtarët kanë nivel të caktuar të vetëdijes për nocionin torturë si formë jologjore e mjekimit, por ajo gjithashtu është e patjetërsueshme që në kontinuitet të zbatohet edukimi dhe me ate të ngritet vetëdija e zyrtarëve policor për të drejtat e personave si dhe mënyra e të vepruarit me persona të privuar nga liria. Vizitat e drejtpërdrejta e institucioneve për paraburgosje kanë vërtetuar se problemi kryesor i numrit më të madh të administrimeve policore është se ata nuk kanë numër të mjaftueshëm të vendeve për paraburgim dhe se kanë kapacitete të kufizuara të hapsirave. Gjatë kohës së vizitës, përfaqësuesët e institucionit të Avokatit të Popullit nuk gjetën persona të privuar në asnjërën prej stacioneve policore. Me kontrollimin e dokumentacionit të personit të privuar nga liria, është vërtetuar se organet kompetente i udhëheqin të gjitha evidencat ashtu si duhet, i kanë të gjitha dokumentet, gjithashtu personat janë të informuar për të drejtat, e gjitha vërtetohet me nënshkrimin e personit të privuar nga liria.

Në Raportin special janë dhënë rekomandime: të ndahen mjetet e duhura buxhetore me qëllim që të realizohen rekomandimet e Avokatit të Popullit të Bosnjës dhe Hercegovinës, të drejtuara deri te ministritë kompetente për punë të brendshme në lidhje me nevojën e adaptimit të hapsirave për paraburgim (në përputhje me standardet e parapara me të Drejtat Evropiane për Burgjet); të ndahen mjete buxhetore të nevojshme për punësimin e personelit të nevojshëm – persona të autorizuar zyrtarë në administrimet policore/stacione, në përputhje me sistematizimin e vendeve të punës; në kontinuitet të organizon stërvitje të specializuara dhe të licencuara, në suaza të stërvitjes profesionale, të personave të autorizuar zyrtar që trajtojnë persona të privuar nga liria, e gjitha në përputhje me standartet më të lara vendore dhe ndërkombëtare të fushës.

Edhe pse mekanizmi parandalues nuk është themeluar në Bosnje dhe Hercegovinë, aktivitetet e këtij mekanizmi janë në përputhje me kapacitetet e tyre.

Në vitin 2018, Avokatët e Popullit e ndyshuan Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim në institucionin Avokati i Popullit i Bosnjës dhe Hercegovinës, me ate që Njësia për mbrojtje të të drejtave të të paraburgosurëve/burgosurëve ishte e riemruar në Njësi për ndjekje të zbatimit të të drejtave të personave të privuar nga liria dhe me ate i zgjeroj kompetencat.

Në lidhje me këtë, kompetencë e kësaj njësie është të shqyrton ankesa dhe të hapi procedurë hulumtuese në të gjitha rastet kur është e mundur shkelja e lirive dhe të drejtave të personave të privuar nga liria, pa marrë parasyshë a janë të vendosur në ent (paraburgim/burg) ose institucion tjetër në të cilin kufizohet liria e lëvizjes. Statistika tregon se në vitin 2018, në këtë njësi janë pranuar 144 parashtresa, që paraqet rritje për 6,67% në krahasim me vitin paraprak. Analiza e ankesave të parashtruar tregon se numri më i madh lidhet me përdorimin e benificioneve para gjyqësore, sigurimi i mbrojtjes shëndetësore në kushte në të cilat janë të



vendosur personat e privuar nga liria, kushte për vendosje dhe mjekim, realizim të të drejtës që të vendosen në institucon tjetër.

Me rëndësi është të përmendet se këtë vit, si pjesë e aktiviteteve, Avokati i Popullit realizoj monitorimin e gjendjeve gati në të gjitha entet përmirësuese në Bosnjë dhe Hercegovinë. Është ardhur në përfundim, ka lëvizje pozitive në punën, funksionimin si dhe përmirësim të kushteve për vuajtjen e dënimeve me burg në shumë ente përmirësuese në Bosnje dhe Hercegovinë.

Aktivitetet e Njesisë për mbrojtje të të drejtave të personave me hendikep rezultojnë me shpalljen e Raportit special për gjendjen me të drejtat e njeriut në institucionet për përkujdesje të personave mentalo-invalidor në Bosnje dhe Hercegovinë, i cili gjithashtu ishte i prezentuar përpara opinionit në vitin 2018.

Në Bosnje dhe Hercegovinë, momentalisht nuk kemi shembuj serioz për hakmarrje. Nëse ka ankesa në ndonjë rast, në atë rast reagojmë menjëherë me atë që e njoftojmë udhëheqjen e institucionit sepse nuk pranohet një sjellje e tillë. Intervistat me persona të privuar nga liria praktikohen në hapsira të specializuara, pa prezencën e personave zyrtar ose të punësuar. Personat e privuar nga liria, gjithashtu, drejtohen deri te ne me shkrim, ku është e garantuar besueshmëria e shkresës.

Duke e pasur parasysh se akoma nuk kemi themeluar MKP, mundohemi që të marrim funksionin dhe obligimet e këtij mekanizmi në mas[ë më të madhe të mundur.

Ju faleminderit për kujdesin



Fidane Zekaj

**Këshilltare juridike e MPN-së
Kosovë**

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, është themeluar Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit.


Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i cili hyri në fuqi më 26 qershor 2015, në nenin 17, paragrafi 1, përcakton: "Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese."

Ligji parasheh që, në kuadër të Avokatit të Popullit, të krijohet një mekanizëm i veçantë, i cili do t'i kryejë të gjitha funksionet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës, sipas Protokollit Opsional të Konventës së OKB-së. MKPT e Kosovës, në përbërje ka juristë, mjekë, psikologë dhe punëtorë socialë. Pra është i përberë prej një ekipi shumë disiplinor, ashtu siç është paraparë me Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së.

Gjatë vitit të kaluar, sikurse edhe gjatë këtij viti, MKPT-ja ka vizituar një numër të madh të stacioneve policore, qendra të paraburgimit, qendra korrektuese, institucionet e shëndetit mendor, qendrat e kujdesit social, Qendrën për Azilkërkues dhe Qendrën e Mbajtjes për të Huaj. Lidhur me këto vizita, MKPT-ja, nga gjetjet e monitorimit, ka nxjerrë raporte me rekomandime, të cilat ua ka përcjellë autoriteteve kompetente.

Duhet cekur se Avokati i Popullit, në të gjitha vendet e privimit nga liria, qysh në vitin 2004 i ka të vendosura kutitë e ankesave, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Mirëpo, edhe pse nuk është mandat i MKPT-së për t'i trajtuar ankesat individuale, MKPT-ja, gjatë vizitave të përgjithshme apo ad-hoc, i hap kutitë e ankesave dhe prej aty mund ta kuptojë situatën e përgjithshme në një qendër, e cila është duke u monitoruar. Ndërsa formë tjetër e pranimi të ankesave është përmes thirrjeve telefonike nga vet personat e privuar nga liria, (funksionon edhe linja falas ku numri është i vendosur në kutitë e ankesave), po ashtu përmes familjarëve, përmes punëtorëve socialë dhe përmes avokatëve.



Pavarësisht formave të përzgjedhjes së personave të privuar nga liria për intervistim, të cilat MKPT-ja i aplikon me qëllim të mos rrezikimit të sigurisë së tyre, ne si MKPT, kemi pranuar ankesa me pohimet se, pas bisedës që kanë zhvilluar me ne, ata janë ndëshkuar ose me ndërrim të pavijonit, ose me ndërrim të dhomës, ose me largim nga puna, apo edhe me transferim në qendrat tjera korrektuese.

Frika nga hakmarrja është një pengesë e madhe për një punë efektive monitoruese. Të gjithë personat që komunikojnë me MKPT-në, të burgosurit, pacientët, punonjësit e qendrave të paraburgimit, punonjësit e spitaleve psikiatrike dhe institucioneve të ngjashme, familja, përfaqësuesit e shtetit dhe të tjerë (në qendra të ndalimit p.sh. nga komunikimi me ambasadat e tyre), duhet të sigurohen se çdo informacion i dhënë mbetet konfidencial dhe nuk do të lejohet paraqesin rrezik për kërcënim të çfarëdo ndëshkimi.

Një strategji e tillë duhet të adresojë gjithashtu edhe kërcënimet e ndëshkimit kundër anëtarëve dhe personelit të mekanizmit. (shembull i MKPT, që do të prezantohet gjatë diskutimeve).

MKPT -ja sa herë që ka marrë informata të ndjeshme ose ankesa gjatë vizitës, ka bërë edhe intervista individuale shpesh për të ruajtur anonimitetin dhe personin si burim të informacionit.

Një formë tjetër e përzgjedhjes për zhvillimin e intervistës, të cilën e praktikon MKPT-ja gjatë vizitës, është përzgjedhja e emrave nga tabelat që janë të vendosura nëpër pavijone, ku janë të shkruar emrat e personave të privuar nga liria. Në këtë mënyrë kemi mundësi që të shmangim rrezikun eventuale që mund t'i kanoset një personi të privuar nga liria, në rast se ai ka parashtruar kërkesë për t'u vizituar nga MKPT-ja. Ndërsa, në disa qendra korrektues, emrat e personave të privuar nga liria figurojnë në derën e qelisë ku janë të vendosur. Kjo praktikë e MKPT-së paraqet lehtësim për përzgjedhjen e një personi të privuar nga liria për të biseduar me të, pa u kuptuar nga autoritetet se ai ka bërë kërkesë për intervistë/takim.

Ne si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në takimet që zhvillojmë, në fillim të vizitës dhe në fund të vizitës, por edhe gjatë takimeve tjera me menaxhmentin, stafin dhe personat e privuar nga liria, në vazhdimësi e theksojmë se ndëshkimet janë të ndaluara në mënyrë eksplicite me të gjitha instrumentet vendore dhe ndërkombëtare dhe se MKPT do t'i trajtoj ato deri në fund. Në këtë drejtim vlen të përmendët bashkëpunimi me Inspektoratin Policor të Kosovës (për rastet e pranimeve të reja) dhe me Inspektoratin e Burgjeve (për rastet që janë në vuajtje) por edhe një bashkëpunim të ngushtë në këtë drejtim kemi me Organizatat Jo-qeveritare.

MKPT ka bërë edhe shpërndarjen e broshurave informuese, tek menaxhmentin, personeli i qendrave, të personat e privuar nga liria, për mundësin e kontaktit në linjën telefonike falas për të parashtruar ankesën si dhe mundësinë që të kenë informacion mbi mandatin dhe metodat e punës të MKPT.

Rastet të cilat pas bisedës me MKPT, janë transferuar ose kemi informacion që janë kërcënuar se do të ndëshkohen, në cilën do formë çoftë, është e mjaftueshme për ekipin e MKPT që t'i kushtojë vëmendje të shtuar dhe të bëhet monitorim i tyre në vazhdimësi (shembull gjatë diskutimeve). Shqetësimet lidhur me këto situata, diskutohen fillimisht me menaxhmentin e qendrës, e nëse është e nevojshme edhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues. Të gjitha këto raste trajtohen me seriozitet nga MKPT dhe Avokati i Popullit duke kërkuar edhe iniciimin e procedurës disiplinore ose penale.

Ndërsa, në të gjitha rastet kur ka pohime për ndëshkim fizik, shikohen dosjet shëndetësore, protokollet e lëndimeve trupore, vet lëndimeve, tentim vet vrasjeve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë, personave me çrregullime mendore si dhe abuzuesve të substancave, të cilët mund të jenë të frikësuar nga ndëshkimi dhe nuk kanë guxim të tregojnë/flasin (shembull gjatë diskutimeve).




Mirëpo, nga vizita e fundit e realizuar në shkurt të këtij viti në Qendrën Korrektuese në Dubravë, e cila është qendra më e madhe korrektuese në Kosovë, kemi pranuar ankesa edhe nga zyrtarët korrektues. Sipas pohimeve të tyre, ata janë marrë në pyetje nga mbikëqyrësit lidhur me atë se çka kanë biseduar me MKPT, të cilin shqetësim e kemi përcjellë tek Drejtori i Institucionit por edhe tek Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Duhet përmendur se në Kosovë, shërbimi shëndetësor i burgjeve, menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë, gjë që ka bërë që të ngritet niveli i shërbimeve, të zvogëlohet numri i ankësive dhe trajtimi i rasteve të bëhet më konfidencialitet më të lartë. Gjithashtu, në procedurat operacionale të veprimit të Shërbimit Shëndetësor të Burgjeve, është paraparë obligimi që në të gjitha ato raste kur qendrat korrektuese pranojnë raste të reja, ndaj të cilave është përdorur forca nga policia apo është përdor forca nga zyrtarët korrektues, apo kur ka pasur përleshje mes të burgosurve, Drejtoria Shëndetësore e Burgjeve e njofton MKPT-në dhe pas hetimit preliminar njofton Inspektoratit e Burgjeve ose Inspektoratin Policor, të cilët kanë mandat për ta hetuar përdorimin e tepruar të forcës, qoftë nga policia apo nga zyrtarët korrektues (shembull gjatë diskutimeve).

Ky bashkëpunim ka ngritur nivelin e sigurisë për të privuarit nga liria dhe ka shtuar kujdesin e sjelljes nga ana e policisë dhe nga ana e zyrtarëve të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

MKPT-ja kujdeset për promovimin e mandatit të vet, në mënyrë që institucionet të besojnë në punën e këtij mekanizmi, duke qenë se mandati ynë është respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria, trajtimi human dhe njerëzor i tyre, dhe jo që autoritetet ta shohin MKPT-në si trupë kritikuese, e shumë shpesh edhe si akuzuese. Në këtë drejtim një kontribut shumë të madh ka dhënë Këshilli i Evropës i cili përmes projektit për forcimin e kapaciteteve monitoruese të MKPT-së, të të gjitha vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria. Përmes këtij trajnimi ekipit të MKPT por edhe pjesëmarrësve të tjerë nga Avokati i Popullit dhe shoqërisë civile, u janë ofruar trajnimet teorike dhe praktike, me ekspertët më të mirë të CTP. Ky projekt ka rezultuar shumë i suksesshëm, dhe ka zgjatur dy vjet.

Garancia më e fortë e mekanizmave efektivë të monitorimit është aftësia e anëtarëve të tyre për të bërë punën e tyre pa kërcënime apo sanksione kundër tyre. Në të njëjtën kohë, një element i rëndësishëm është mbrojtja kundër hakmarrjeve për të burgosurit pas kontakteve të tyre me monitoruesit, çofshin ata të MKPT ose shoqëria civile.



Aneks I - Rendi i ditës për Takimin e parë të rrjetit të mekanizmave parandalues nacional të vendeve të Evropës Juglindore në vitin 2019

osbe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

“Strategjia nacionale e mekanizmave parandalues për parandalim dhe mbrojtje nga represaliet”

Takimi i parë i rrjetit të MPN të Evropës Juglindore

11-12 Qershor 2019, h. ARKA, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

10 Qershor 2019

19:00 - 21:00 Arritja e pjesëmarrësve
Darka e shërbyer në hotel

11 Qershor 2019

09:00 - 09:30 Regjistrimi i pjesëmarrësve

Fjalime hyrëse:

09:30 - 09:50 z. **Ixhet Memeti** – Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Ambasadori Clemens Koja – Shefi i Misionit të OSBE-së në Shkup

Prezantimet:

10:00 - 10:30 **Znj. Vjollca Rushaj**, këshilltare shtetërore për prevenim nga tortura,
Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (Moderatore e Takimit të parë të rrjetit të MPN të Evropës Juglindore)

Përfaqësues të Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës të KB

z. Kosta Mitroviq – Anëtar i Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës (SPT) të KB

z. Armen Avetisyan – anëtar i Sekretariatit të Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës (SPT) të KB



10:30 - 11:00

Diskutime

11:00 - 11:30

Pushim i shkurtër dhe fotografim i grupit

11:30 - 12:30

Prezantime nga anëtarë të Mekanizmave Parandalues Nacional:

- MPN Shqipëri
- MPN Austri
- MPN Bulgari
- MPN Kroaci
- MPN Greqi

12:30 - 13:00

Diskutime


13:00 - 14:30

Pushimi i drekës

14:30 - 15:30

Prezantime nga anëtarë të Mekanizmave Parandalues Nacional:


- MPN Hungari
- MPN Maqedonia e Veriut
- MPN Mali i Zi
- MPN Slloveni
- MPN Sërbi
- MPN Bosnja dhe Hercegovina
- MPN Kosovë



15:30 - 16:00	Diskutime
19:30 - 21:30	Darkë zyrtare


12 Qershor 2019

09:30 - 10:00	Diskutime dhe përmbledhje të diskutimeve nga dita e parë
10:00 - 10:30	Miratimi i konkluzioneve
10:30 -i 11:00	Pauzë për kafe
11:00 - 12:00	Brifing dhe diskutime për planet e ardhshme të Rrjetit (aktivitete, takime, konferenca)
12:00 - 13:00	Dreka
13:00	Nisja e pjesëmarrësve



Aneks II- Lista e pjesëmarrësve

1. Ixhet Memeti, Ombudsman of the Republic of North Macedonia
2. Ambassador Clemens Koja, Head of the OSCE Mission to Skopje
3. Ermonela Xhafa, Commissioner , Ombudsman institution of Albania
4. Genci Terpo, Assistant Commissioner, Ombudsman institution of Albania
5. Besnik Deda, Assistant Commissioner, Ombudsman institution of Albania
6. Peter Kastner, Austrian Ombudsman Board
7. Ivelina Velkova, Chief Expert, Office of the Ombudsperson of Bulgaria
8. Silviya Slaveva, Senior Expert, Office of the Ombudsperson of Bulgaria
9. Maja Kevic, Deputy Ombudsman, Ombudsperson of the Republic of Croatia
10. Anica Tomsic Stojkovska, Legal Affairs Advisor, Ombudsperson of the Republic of Croatia
11. Chrysoula Antoniou, Special investigator, Greek Ombudsman's Office
12. Evangelija Markaki, Special investigator, Greek Ombudsman's Office
13. Izso Krisztina, Senior Legal Advisor, Fundamental human rights of Hungary
14. Istvan Sarkoezy, Senior Legal Office, Fundamental human rights of Hungary
15. Vjollca Rushaj, state counselor, NPM of the Republic of North Macedonia
16. Irina Aceska, counselor , NPM of the Republic of North Macedonia
17. Aleksandar Trenkoski, counselor, NPM of the Republic of North Macedonia
18. Bardhyl Limani, legal officer, Office of the Ombudsperson of the Republic of North Macedonia, UNHCR team
19. Martin Duvnjak, legal officer, Office of the Ombudsperson of the Republic of North Macedonia, UNHCR team
20. Jana Dzekov, project assistant, Office of the Ombudsperson of the Republic of North Macedonia, UNHCR team
21. Jana Dukovska, legal officer, Office of the Ombudsperson of the Republic of North Macedonia, UNHCR team
22. Zdenka Perovic, Deputy Ombudsman, Ombudsperson's Office of the Republic of Montenegro
23. Daniela Brajkovic, Advisor, Ombudsperson's Office of the Republic of Montenegro
24. Shucko Bakovic, Ombudsman, Ombudsperson's Office of the Republic of Montenegro
25. Ivan Selih, Deputy Ombudsman, Office of the Ombudsperson of the Republic of Slovenia
26. Tamara Blagojevic, Head of NMP, Protector of Citizens of the Republic of Serbia
27. Jelena Samardzic, Independent Advisor, Protector of Citizens of the Republic of Serbia
28. Vedrana Pavlovic, Assistant Ombudsman, Office of the Human Rights Ombudsperson of Bosnia and Herzegovina
29. Vanja Dandic, Expert Advisor, Office of the Human Rights Ombudsperson of Bosnia and Herzegovina
30. Hasime Terziqi, Doctor, Office of the Ombudsperson of Kosovo
31. Fidane Zekaj, Legal Advisor, Office of the Ombudsperson of Kosovo
32. Kosta Mitrovic, SPT member
33. Armen Avetisyan, Human Rights Officer, SPT
34. Vaska Bajramovska Mustafa, deputy ombudsman of the Republic of North Macedonia
35. Suzana Salju, deputy ombudsman of the Republic of North Macedonia
36. Jovan Andonovski, deputy ombudsman of the Republic of North Macedonia
37. Demir Hamiti, Ombudsperson's Office of the Republic of North Macedonia
38. Naxhie Kurtishi, Ombudsperson's Office of the Republic of North Macedonia
39. Marija Llazarova, Ombudsperson's Office of the Republic of North Macedonia



40. Sllavica Dimitrievska, Ombudsperson's Office of the Republic of North Macedonia
41. Angela Lazarevska, Ombudsperson's Office of the Republic of North Macedonia
42. Monica Sandri, UNHCR representative
43. Dejan Kladarin, Senior protection officer, UNHCR
44. Tatjana Bundaleska, protection associate, UNHCR
45. Zhaneta Poposka, OSCE
46. Sillvana Boshkovska Georgievska, OSCE



**Aneks III - Përfundimet dhe rekomandimet nga Takimi i parë i rrjetit të mekanizmeve parandalues
nacional të vendeve të Evropës Juglindore në vitin 2019**

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET E TAKIMIT TË PARË

1. NPM-të duhet të jenë të vetëdijshëm se masat ndëshkimore dhe frikësimet mund të ndodhin në të gjitha “vendet e ndalimit”. Ndjekja e “parimit -mos dëmto” garanton që, askush nuk do të jetë subjekt i sanksioneve, për shkak të përbushjes së mandatit të NPM-së.
2. Aktivitetet e ndërgjegjësimit do të ndihmojnë në krijimin e një platforme besimi për të inkurajuar të gjithë njerëzit të flasin lirshëm me përfaqësuesit e NPM-së, duke qenë të sigurt se parimet e konfidencialitetit nuk do të shkelen.
3. Duke ndjekur politikat e SPT-së për masat ndëshkimore, çdo NPM duhet të krijojë një strategji dhe metodologji individuale, si të parandalojë masat ndëshkimore dhe çfarë duhet të bëhet, kur ndodhin masat ndëshkimore.



Fotografi e përbashkët e pjesëmarrësve të takimit, 11.06.2019





Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission to Skopje



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT

Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

1ST MEETING OF THE SOUTH EAST EUROPE NATIONAL PREVENTIVE MECHANISM NETWORK IN 2019

Skopje, Republic of North Macedonia

Title: *1st Meeting of the South East Europe National Preventive Mechanism Network in 2019*

Publisher: Ombudsman Office of the Republic of North Macedonia

Redactor: Ombudsman Office - National Preventive Mechanism

Language editing: Ombudsman Office

Design: Keti Stefkova

Copies: 100

CONTENTS



Ixhet Memeti , <i>Ombudsman of the Republic of North Macedonia</i>	139
Ambassador Clemens Koja , <i>Chef of the OSCE Mission to Skopje</i>	141
Ermonela Xhafa , <i>Commissioner at Ombudsman of Albania</i>	143
Dr Peter Kastner , <i>President of legal group in Austrian Ombudsman Board</i>	148
Silviya Slaveva , <i>senior expert in Office of the Ombudsperson of Bulgaria</i>	151
Maja Kević , <i>Deputy Ombudswoman of the Republic of Croatia</i>	155
Chrysoula Antoniou , <i>Special investigator in the Greek Ombudsman</i>	158
Evangelia Markaki , <i>Special investigator in the Greek Ombudsman</i>	161
Krisztina Izsó and István Sárközy , <i>Senior legal advisers of OPCAT NPM Department, Hungary</i>	166
Aleksandar Trenkoski , <i>Adviser for prevention of torture, NPM of the Republic of North Macedonia</i>	171
Zdenka Perovic , <i>Deputy Ombudsman of Montenegro for the NPM</i>	174
Ivan Selih , <i>Deputy Ombudsman and Head of the NPM of the NPM of Slovenia</i>	178
Jelena Samardžić , <i>Independent advisor in NPM Serbia</i>	180
Vedrana Pavlović , <i>Head of the Department in the Ombudsman Institution for Human Rights of Bosnia and Herzegovina</i>	182
Fidane Zekaj , <i>Legal advisor in NPM Kosovo</i>	185
ANNEX I - <i>Agenda of the 1st Meeting of the South East Europe National Preventive Mechanism network in 2019</i>	188
ANNEX II - <i>List of participants</i>	191
ANNEX III - <i>Conclusions and recommendations of the first meeting of the South East Europe national preventive mechanism network in 2019</i>	193

The Ombudsman of the Republic of North Macedonia- the National preventive mechanism, on 11th and 12th June 2019, for the first time hosted and moderated the South-East Europe NPM Network, which this year celebrates 6 years since its first establishment.

This event was financed by the OSCE Mission in Skopje.

The first meeting of the South-East Europe NPM Network was focused on the protection of reprisals strategy as well as adjustment of the common methodology for prevention and protection from reprisals used on persons who cooperate and share certain information with the national preventive mechanisms.

On this event, along the ombudsman Mr. Ixhet Memeti, their addressing had the ambassador of the OSCE mission in Skopje Klemens Koja, members of the Subcommittee for prevention of torture of the United Nations, representatives of the national preventive mechanisms of Albania, Austria, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Greece, Kosovo, North Macedonia, Serbia, Slovenia, Hungary, Croatia and Montenegro.

